




PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **24.09.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 26.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të nëntë të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE



1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.235/24 i datës 25.07.2024 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2025;
5. Shqyrtimi i Informatës nga DKA-ja, për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025;
6. Shqyrtimi i Informatës nga DKRS-ja, rreth muajit të mërgimtarëve;

Shtesë:

1. Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës - lokalet afariste të stacionit të autobusëve në Rahovec, personave fizikë dhe juridikë;
2. Vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe dhe shqyrtimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës - lokalet e stacionit të autobusëve - Rahovec;

Kryesuesi: Atëherë, kush është “për” që këto dy pika shtesë të jenë në rend dite? Unanimisht (19) votohen këto dy pika shtesë.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë, ekzekutiv, monitorus, të gjithë prezentë. Një sqarim rreth dhënies në shfrytëzim të lokaleve afariste të stacionit të autobusëve: Ligjërish a jemi në rregull, sepse është ndërmarrje publike – komunale? A i jep komuna, a i jep ndërmarrja? A ka marrëveshje me ndërmarrjen rreth lokaleve? Mendoj që nëse asambleja komunale merr vendim për t’i dhënë në shfrytëzim përmes një komisioni, atëherë, ka mundësi reale të kthehet prapa, sepse kjo është kompetencë e ndërmarrjes publike komunale – stacioni i autobusëve Rahovec. A është sqaruar ky pozicion?

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit. E kam diskutuar edhe me zyrën ligjore dhe fakti është që prona është në emër të Komunës së Rahovecit dhe është në shfrytëtim te stacioni i autobusëve. Sipas zyrës ligjore gjithçka është në rregull. Ne i zhvillojmë procedurat dhe inkasimi i mjeteve bëhet nga stacioni i autobusëve.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë, të nderuar anëtarë, e vendosim në votim rendin e ditës së bashku me dy pikat shtesë, pra 8 pika. Kush është “për”?... Unanimisht (24) votohet rendi i ditës për mbledhjen e nëntë të kuvendit komunal.

Kryetari: I nderuar kryesues Arbër Zenuni, drejtorë, nënkryetar i komunës, anëtarë të kuvendit të komunës, përfaqësues të mediave dhe të LMT-së. Sot është 24 shtatori, dita e asaj që cilësohet si sulm terrorist nga ana e qarqeve shtetërore të Serbisë, dikush e cilëson agresion, dikush invazion. Sot është një vjetori i ngjarjes në fshatin Banjë në pjesën e veriut të Kosovës dhe e kemi gjithashtu përvjetorin e parë të heroit të Republikës së Kosovës, zyrtarit policor Afrim Bunjaku. Ju kërkoj një minutë heshjte në nderim të veprës së tij... Lavdi!

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A kemi ndonjë koment apo diskutim nga anëtarët e kuvendit rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht (24) aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Kësaj radhe nuk dola të bëjë pyetje, por, një diskutim të shkurtër dhe besoj që do të qëndroj brenda minutazhit që e kam. Po e filloj me një thënie: “Kur shqiponja shkoi ta ndërtojë qerdhen me një list të lartë, e sheh kërmillin dhe e pyeti: si erdhe deri këtu? Ia kthen ai: duke u lëpirë ngadalë! Sjelljet dhe qasjet duhet të jenë të kujdesshme. Gjuha e shantazhit i takon vetëm grupeve mafioze dhe nuk i takon qytetarëve të rëndomtë. Kushdo që pretendon që përmes shantazheve të caktuar ta ndalë Burimin, është shumë gabim. Kjo punë nuk dhezë dhe nuk funksionon. Unë jam këtu dhe LDK-ja është këtu. Nuk jam unë ose LDK-ja këtu për qejfe të dikujt, por, është ajo që qytetarët e vlerësojnë që LDK-ja të jetë këtu, me aq sa i kanë dhënë “takat” e besim. Nuk mund të tentoni që t’i jepni kahje të ndryshme punëve të këqija, me tendencën që të duket “ujk nën lëkurën e qengjit”. Nuk mund të thoni heshtni, që rreth 700.000€ janë gjuajtur në përrockën, Hoçë e Madhe – Krushë e Madhe që nuk është bërë kurrë. Nuk mund të thoni heshtni, për përrockën në Celinë, e cila është shembur në vitin e parë. Nuk mund të thoni heshtini, për projektet që nuk po i qëndrojnë kohës asnjë ditë. Së fundi, e kemi fushën e sportit në Gur të Kuq, është bërë me gropa, i kam edhe fotografitë në telefon. Nuk mund të thoni heshtni, kur palestra e sporteve në qytet, është përruar në 2018-2019, në 2023 i pikon çatia, rinovohet çatia dhe në 2024 pikon përsëri gjatë një ndeshjeje të futsallit. Nuk mund të themi që është në rregull, kur në Muzeun e Masakrës në Krushë të Madhe, uji ka hyrë brenda në shiun e parë. Nuk mund të thoni heshtni, kur në projekt është paraparë që dera e muzeut të jetë e drurit e gdhendur dhe jo e aluminit. Beton i bardhë dhe jo i rëndomtë. Ju them me përgjegjësi, hulumtoni ku të doni dhe nëse ka një zyrtar të LDK-së të Komunës së Rahovecit, në nivel qëndror dhe lokal, i cili ndonjëherë ka pasur aktakuzë, hajdeni këtu dhe unë jap përgjegjësi. Nuk ka pasur kurrë LDK-ja, anëtarë që kanë kërkuar harraq nëpër biznese. Nuk mund të themi që jemi në rregull, kur zyrtarët e caktuar pranojnë fajësinë dhe i largojmë se na “qiti faqen e zezë”. LDK-ja nuk ka zyrtarë që herë shkojnë në gjykatë, herë i mbajnë pozicionet e veta. Nuk është kjo gjuha ime që kam dashur ta përdorë, po detyrohem, sepse nuk lejoj që askush të manipulojë me asgjë. Provojeni si të keni qejf, këtu jemi! I kërkoj falje zyrtarit përgjegjës, por, nuk mund të shitemi patriot dhe me pasë aktakuzë për keqpërdorim në tenderin për furnizim me material ndërtimor për familjet skamnore. Nuk mund të themi patriot, kur në këtë komunë ka aktakuzë të ngritur ndaj zyrtarit për keqpërdorim të pozitës në projektin “Pllakata - Altari i Lirisë”. Kam menduar që do të jemi më të kulturuar dhe më të kujdesshëm, do t’i japim komentet tona, sugjerimet, mospajtimet, por, punëve të këqija nuk do t’i duartrokasim asnjëherë. Ballafaqohemi publikisht, ligjërisht, apo në çfarëdo debati. Nuk mund të themi që është në rregull asfaltimi i rrugës “Gëzim Hamza” që është asfaltuar para 3-4 dite, është për “marre të zotit”. Nëse mendoni që të gjithë duhet t’i duartrokasim këtyre punëve, është gabim. Unë ju them që mos tentoni ta përdorni gjuhën e shantazhit, sepse te unë nuk funksionon hiç. Nëse pak frikohem, rri në shtëpi. Për këdo dhe në çfarëdo forme, unë jam këtu. Shantazhi është gjuhë e grupeve mafioze, nuk është gjuhë e njerëzve normal. Ju kërkoj falje për këtë diskutim, qytetarë të nderuar, ju kërkoj falje që përmenda njerëz që nuk kanë kontest apo raport me mua në këtë drejtim, por fatkeqësisht – fatbardhësisht këtu jemi dhe ndonjëherë po detyrohem.

Kryetari: I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive! Është një thënie persiane: “I urti i rrahur, me uthull me vaj, mendohet përpara – hap gojën pastaj!” Gjithashtu edhe unë i kërkoj falje qytetarëve për diskutimin sot, sepse ndoshta nuk është në përputhje me rendin e ditës. Njerëzit që promovohen si institucionalistë, nuk e kanë largë objektin e gjykatës dhe prokurorisë. Ata i dinë adresat, sepse ndoshta kanë pasur punë edhe më herët atje, te Njësi i Hetimeve të Krimeve të Rënda dhe të policisë. Pra, njerëzit që kanë përgjegjësi institucionale dhe politike i kanë adresat e qarta. T’i thuash dikujt që je me aktakuzë apo me korrupsion, përsëri lidhet me logjikën

institucionale, sepse duhet të jesh kryetar i trupit gjykues dhe vendimi duhet ta marrë formën e prerë që t'i themi dikujt kështu apo ashtu. E sidomos kur një anëtar i kuvendit, që tani e mora vesh që ka marrë përsipër që të merret edhe me kualifikime. Ky anëtar i kuvendit duhet të di për veten se kush është? Çka përfaqëson? Nga kush është zgjedhur? Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e tij dhe a i ka shkuar ndonjëherë policia te dera dhe për çka i ka shkuar? Mos të futemi në atë, sepse populli thotë që në fund të del "xhizë". Unë jam elektron i lirë, jam pa hipoteka të së kaluarës, nuk jam pengë i askujt dhe prandaj të jemi të vëmendshëm se çka po flasim. Po e përsëris, nëse dikush shantazhohet, atëherë adresat i ka të qarta. Sa i përket dobësive në qeverisje, në asnjë çast, kurrë nuk kemi thënë që jemi perfekt, pavarësisht asaj që qëllimet tona janë ta kryejmë punën 100%. Një njeri i zgjedhur me përgjegjësi institucionale e din që për kontrata ka mbikëqyrje, ka menaxhim dhe po ashtu ka mekanizma të veprimit institucional që t'i japim përgjigje nëse ka gabime. Pra, nëse vërtet kanë bërë shkelje, ata që kanë përgjegjësi që mos të bëjnë shkelje, atëherë ka adresa. Po më qudit fakti që një njeri që i prin një subjekti politik, ka logjikë anarkiste. Nuk din kush vendosë për një çështje, nuk e din adresohet një çështje, nuk din që ka njësite të veçanta për hetimin e krimeve të rënda, nuk din që ka gjykatë dhe merret me kalifikime, të cilat nuk janë përgjegjësi e tij e as e imja. U përmend që "jemi këtu". Duhet të provojmë që mos të bëhemi snob. Ti e imiton Ibrahim Rugovën, ish presidentin e Republikës së Kosovës, ai ka thënë "jemi këtu". "Jemi këtu" kur ka qenë Serbia, tani jemi në rrethana tjera. Çka do të bëhej nëse themi që edhe ne jemi këtu, bile bukur gjatë jam në këtë institucion. Për të ardhmen nuk e di se çka do të vendosë qytetari, por edhe ne jemi këtu. Nëse ju po kapeni për një fije kashtë, populli thotë "nxirr një kashtë e dalin gjashtë". Me atë që je marrë nuk m'u duk interesat fare. Pse dikush e ka përmendë një vendbanim për pak zallë dhe merreni me mend, një subjekt politik ngritet dhe reagon, për një situatë shumë normale. Subjekti politik, a nuk ka tema më serioze se sa të merret me atë që a ka zallë në Celinë, a në Rahovec a Drenoc? Sidoqoftë, është e panevojshme, e paarsyeshme dhe e nxitur artificialisht. Sa i përket përroit: Nuk kanë shkuar asnjëherë 700.000€. Pandeminë e kemi përjetuar të gjithë, dikush ka vdekë e te dikush ka ndikuar edhe në harresë. E kam përmendur që e kemi trashëguar një projekt nga koha e z. Qeska, ka pasur probleme pronësore, ka pasur edhe kontratë të lidhur dhe projekti ka dështuar, por, nuk janë dhënë ato para. Kujtesën e kam shumë të zhvilluar: Ka qenë firma "Vëllezërit Krasniqi", të cilët nuk kanë arritur ta implementojnë projektin. Ka pasur përpjekje për kontrata të reja, e kemi lidhur një kontratë në atë që jemi bazuar që kontratën do ta financojë Ministria e Planifikimit, kjo e fundit e ka ndërprerë financimin, janë dhënë rreth 175.000€ për këto veprime të cilat kanë ndodhur. Ju e dini që tani një pjesë të grantit të performancës e kemi dedikuar në këtë projekt dhe tani kemi kontratë aktive dhe operatori është duke punuar. Përroi në Celinë është e vërtetë që ka pasur një defekt, që po ashtu ka qenë një kontratë e trashëguar nga z. Vehapi. Kontrata ka qenë aktive dhe e kemi përfunduar. Ka pasur probleme me vërshime dhe nuk kemi pasur mundësi ta riparojmë përsëri. Ka skaduar afati i ndërhyrjes së operatorit dhe ka ngelur ashtu. Ju nuk i dini gjërat, sepse shkoni shëtiteni vetëm kur të bëhet puna e fushatës. Ne jemi në terren çdo ditë, sepse na obligon edhe mandati. Gjithashtu aty është edhe një gyp i sistemit të ujitjes që bëhet pengesë. Fusha sportive në Gur të Kuq: Ne e kemi një raport që është dëmtuar. Ajo fushë fillimisht ka qenë nën menaxhim të të gjithë qytetarëve, pa dallim. Drejtori i shkollës e ka bërë një shqetësim, ne e kemi riorganizuar në kuptimin e menaxhimit dhe ia kemi dorëzuar qelsat vetëm drejtorit të shkollës. Te palestra e sporteve: Po, është e vërtetë që ka defekte dhe është e vërtetë që është riparuar kulmi. Shumë mirë që kulmin e ka marrë Euro-ingu dhe ai është munduar të punojë në kulm me elementet e parapara në kontratë. Ne kemi plan konkret për riparim të palestrës dhe për të gjitha defektet, po e potencoj "jemi këtu, jam këtu". Muzeu i Masakrës është e vërtetë që ka pasur probleme me kulm dhe po ashtu ka pasur përpjekje nga ana e operatorit për riparim dhe me gjasë është rregulluar. Te Rruga "Gëzim Hamza" janë duke u bërë disa veprime shtesë, pse po nxiton të flasësh, ndoshta do të ketë edhe një shtresë. Ndërvarësinë që e kemi me KRU Gjakovën dhe vonesat e shkaktuara nga ata, ne fund kemi arritur ta përfundojmë dhe fakti që është duke ndodhur që të eliminohen të gjitha defektet që mund të paraqiten janë të parapara me kontratë e cila është aktive. Te çështja e shantazhit, kërcënimeve dhe grupet mafioze që i përmendi dikush, është mirë që t'i kemi jashtë kuvendit dhe mirë është që të secili të reflektojë në atë që përfaqëson. Anarkist nuk kam qenë as në atë kohë kur ka qenë vështirë, nuk jam as sot. Për çdo gjë fyese apo shantazh, e kemi adresën, ashtu siç e kam edhe unë. Duhet të reflektojmë përgjegjësi institucionale dhe duhet të operojmë me logjikë të shëndoshë të institucionalistëve. Kryetari i partisë suaj nëpër të gjitha mediat thotë që ne jemi parti institucionaliste, është e vërtetë dhe nuk besoj që ende ka parti joinstitucionaliste, si dhe është mirë t'i drejtoheni

organeve të caktuara, “më ka shantazhuar Smajl Latifi”. Vjen prokurori më merr në pyetje, më thotë se pse e keni shantazhuar, unë i them që jo, ti thua po, vendosë gjykata dhe në rregull jemi. Mos paragjykoni, ne kemi shumë njerëz me aktakuza në Republikën e Kosovës, pa vendim të formës së prerë. Madje edhe vendimi i gjykatës themelore nuk konsiderohet vendim i formës së prerë, sepse është edhe gjykata e apelit për ankesë. Ta presim finalen dhe takohemi në finale. E di për kë e pate fjalën. Ai është me shëndet jo të mirë, e ka marrë vendimin e gjykatës, jo të formës së prerë dhe ne së pari i urojmë shërim të shpejtë dhe t’ia japim mundësinë mjekëve që të kontribuojnë në trajtimin e ktyre rasteve. Sa i përket drejtorive, është dikush me aktakuzë, por, do të merr epilog në fund. Të mos ngutemi, sepse pak para zgjedhjeve të vitit 2021, disa u ngutën duke thënë që kryetari i komunës nuk i zbaton vendimet e inspektoratit, por, me 4 tetor unë jam në gjykatë. Nuk shkoj atje, sepse kam punë më të menqur. Këtu i kam kërkuar dëmshpërblim 100.000€ për dëmin e shkaktuar. Mos të ngutemi, shteti është i yni dhe jo i Serbisë. Shteti është demokratik, parlamentar dhe me pushtete të pavarura. Në këtë kohë, serioziteti i një politikani varet se si sillesh në raport me institucionet që nuk janë kompetencë e jotja. Burim, unë nuk i përziej pushtetet dhe mos e bëni punën që siç thoshte Isa Mustafa me “duar në xhepa” t’i kryej punët. U mundova të jem i kujdesshëm. Ta orientojmë këtë mbledhje në tema që njëmend lidhen me rendin e ditës dhe mos të kalojmë jo domenin e asaj “më shantazoi”, “nuk jam frikacak”. Ne të gjithë jemi këtu dhe nuk e kemi në plan të largohemi nga këtu sepse është vendi ynë dhe unë nuk kam vend tjetër, besoj që nuk ka as Burimi.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! Përsëritet për të gjithë. I nderuar kryetar, nënkryetar, kryesues, anëtarë të kuvendit, drejtorë, media. Meqenëse u tha një thënie popullore dhe një persiane, unë po e them një thënie latine: “Wox clamantis in deserto” – “Një zë që klith në shkretëtirë”. Debatet e parafolësve të mi janë të padobishme për qytetarët e Komunës së Rahovecit. Nëse ka akuza të tilla të ndërsjellta, atëherë mund të diskutohen në organet e drejtësisë dhe të zgjidhen atje. Banorët e Komunës së Rahovecit po përballen me mungesën e ujit të pijshëm. Meqenëse kryetari e liroi sallën, kërkoj nga drejtori i Shërbimeve Publike, i cili po ashtu e liroi sallën. Kërkoj nga nënkryetari, që të merr hapa konkret si institucion i Komunës së Rahovecit, të bënë kërkesë të ashpër ndaj KRU Gjakovës, sepse tani edhe zyrtarisht jemi në stinën e vjeshtës dhe pas reshjeve të shiut mund të ketë arsye të mungesës së ujit, nuk mund të jenë as temperaturat e larta, apo niveli i ujit në liqenin e Radoniqit. Nuk besoj që duhet të ketë arsye që qytetarët e Komunës së Rahovecit në përgjithësi dhe të lagjes së epërme në qytet në veçanti, të përballen me mungesa të ujit dhe reduktime në orët e natës. Meqenëse buxheti i Komunës së Rahovecit do të shqyrtohet për miratim në këtë seancë, atëherë, unë kërkoj prej kryetarit që një punë që nuk ka pasur mundësi ta bëjë për tre mandate dhe që kam bërë kërkesë shumë herë, është problemi me energji elektrike në rrugën “Vëllezërit Frashëri”, por edhe në lagjen e epërme. Është problem mungesa pronës publike në vendosjen e trafos elektrike, e cila do ta rregullonte këtë problem. Ka forma të ndryshme, e para mund të jetë që të bëhet një ndarje buxhetore për shpronësimin e pronave private, meqenëse mungojnë pronat publike në këto lagje. Çështja e infrastrukturës në Komunën e Rahovecit: Rrugët janë për t’u ardhur keq, e përmendën parafolësit që rruga “Gëzim Hamza-piktori” më vie mirë që është pranë rregullimit final, por janë edhe shumë rrugë të tjera që kanë nevojë për trajtim, sidomos rrugët dytësore, për të cilat kemi folur gjatë gjithë mandatit. Në raportin gjashtëmujor të punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike thuhet që njëra prej punëve që është përfunduar: Kycja në kanalizim e banorëve të rrugës “Vëllezërit Frashëri”. Në këtë rrugë, në mungesë të kanalizimit janë mbi 300 shtëpi dhe zgjidhja është bërë për vetëm 50 shtëpi. Po më vjen keq prej kësaj papërgjegjësie të ekzekutivit duke filluar prej kryetarit, drejtorit të Shërbimeve Publike, sepse është obligim moral që të vijnë këtu t’i dëgjojnë hallet e qytetarëve, kur ata zgjedhin të dalin jashtë. Një çështje tjetër që është kryesorja: Një projekt që po kushton 320.000€ dhe po paguhet prej taksave të qytetarëve. Komuna e Rahovecit për këtë projekt e ka hedhur mundin e të rinjve, arkitektave dhe inxhinierëve, fjala është për çështjen e Ballkonit Panoramik. Komuna e Rahovecit duke e shfrytëzuar thirrjen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe duhet e shfrytëzuar idenë e të rinjve të kësaj komune, që me mundin e tyre për një kohë të gjatë kanë kontribuar që të finalizohet projekti “Grapeland”. Të gjithë qytetarët për këtë projekt kanë qenë të pajtimit dhe entuziazmi për implementimin e këtij projekti ka qenë shumë i madh. E kam diskutuar edhe me kryetarin në një takim që e kemi pasur me grupin punues për plotësim ndryshimin e statutin e Komunës së Rahovecit, si dhe kam dalur publikisht që kjo ide është përvetësuar prej kryetarit të komunës dhe ka filluar implementimi. Pavaërisht kësaj, e ftoj kryetarin që ta ftoj ojç-në “Grapeland” dhe të dalin ta përkrahin kryetarin në

implementimin e këtij projekti dhe që shkronjat që vendosen në kodër mbi Rahovec, të quhen “Grapeland” e jo “Grapecity”. E ftoj kryetarin që t’i lë anash inatet, sepse nuk ka arsye tjetër që ta shëmtojë projektin në këtë formë. “City” në terminologjinë angleze nuk përfaqëson një qytet, sikur ne që i vlerësojmë qytetet në Kosovë. “City” nuk mund të jetë as Prishtina, e lëje Rahoveci! Mund të jetë LondonCity, apo NewYorkCity. Nëse dëshirojmë ta bëjmë “Town”, përsëri Rahoveci nuk mund ta merr këtë term. Me bë shqip, ndoshta nuk i ka hije, sepse turistat tërhiqen më shumë prej gjuhës angleze. Inxhinierat dhe arkitektat sa do të rinj që kanë qenë, e kanë menduar mirë këtë pjesë duke e emëruar “Grapeland”, sepse “land” është toka që i përfshin të gjitha pjesët. Rushi nuk kultivohet veç në qytet, është edhe në rrethinë, por, edhe Suhareka ka rrush. Nëse e bëjmë “Grapeland” e përfaqësojmë komplet rajonin, që ka rrush edhe në rrethinë, por epiqendra është në Rahovec. I kam bërë thirrje edhe nënkryetarit, drejtorave, anëtarëve të kuvendit dhe të gjithë atyre që mbshtesin Aleancën në Komunë të Rahovecit, që të bisedojnë me kryetarin dhe të kërkojnë që për të mirën e interesit të përgjithshëm ky projekt të quhet “Grapeland” dhe jo “Grapecity”.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Po kyçem me çështjen e fundit që e diskutoi Defrimi. Është hera e disatë që e kam ngritur këtë çështje, por nuk mund ta lë me kaq, duke mos e bërë edhe një thirrje të fundit ndaj kryetarit. Kronologjinë besoj që e dini të gjithë, sepse e kam shtjelluar disa herë. Ne si grup e kemi bërë kërkesën që ta kemi një takim me kryetarin dhe të jetë një mirëkuptim dhe bashkëpunim i fundit, por nuk ka pranuar. Kërkesa jonë ka qenë që të paktën kërkesa kryesore e qytetarëve që të implementohet emri “Grapeland” dhe jo “Grapecity”. Përderisa ai nuk na ka pranuar në zyrë neve si grup, apo mua si këshilltare komunale, po e shfrytëzoj rastin prej kësaj foltore që ta bëj kërkesën publikisht, të lutem ruaje emrin “Grapeland” dhe mos e shëmto duke e bërë “Grapecity”.

Drilon Mustafa: Përshëndetje për të gjithë kolegët! Pasi e filluar të gjithë me thënie, po e filloj edhe unë: “Kur dikush thotë diçka dhe nuk beson në të, sigurisht befasore kur dikush tjetër e realizon atë projekt”. Unë mendoj që ju edhe kur e keni bërë projektin, keni menduar që nuk realizohet kurrë. Ne kemi informacione që kryetari ju ka ftuar në atë kohë. Ju nuk keni pranuar ta jepni projektin për komunë, keni dashur t’ia shitni komunës. Nuk është që e keni zbuluar “ujin e nxehtë”, sepse ka mijëra raste që këto shkronja vendosen nëpër shtetet e botës. Nëse ndodh kjo që të bëhet “Grapeland”, unë nuk pajtohem, duhet të jetë një konkurs publik, sepse ndoshta ka ide edhe më të mirë. Në atë kohë edhe unë kam qenë me juve, ju ka shkruar, por nuk më keni pranuar në grup. Keni dashur që grupin ta keni vetëm me 2-3 vetë, sigurisht që qytetarët i kanë besuar njerëzve që kryejnë punë dhe kryetari ka vendosur ta kryej këtë punë.

Faton Ramadani: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë. Dëshiroj t’i ngris dy çështje që janë në interes të shkollave. Meqë drejtori i Arsimit është këtu, po i drejtohem atij. Sigurisht është në ngjarje që shumica e shkollave po ballafaqohen me fotokopjues jofunksionalë, apo funksionojnë me vështirësi. Drejtor, ju e dini gjendjen e toaleteve, nyjet sanitare në shkollën “Faik Konica” qëndrojnë jo mirë. Ju lutem të merrni iniciativë, t’i riparoni dhe t’i ktheni në gjendje normale, sepse shumë nxënës kanë probleme dhe po shkojnë në shtëpitë e tyre t’i kryjnë nevojat fiziologjike.

Merisa Sharku: Për të “dhezur” një ide ashtu siç ka qenë Grapelandi, duhet të jesh një ideator më i fortë. Ti e pasur mundësi, ke mundësi po ashtu, sepse je shumë afër pushtetit dhe nëse e jep një ide kaq të fortë, ndoshta ta realizon ty. Ndoshta për ne nuk e ka realizuar, veçse nuk jemi në parti të tij. Sa i përket asaj që nuk të kemi pranuar në grup, unë nuk e di se ku e keni bërë atë kërkesë dhe nëse ke ndonjë email apo diçka të tillë, atëherë përgjigju. Fillimisht te ideja ka qenë grupi më i vogël, pasi që e kemi bërë idenë, nuk e di si ta pranojmë dikë tjetër që veç të jetë pjesë.

Defrim Kafexhiu: Meqenëse arkitektat janë më kompetentë në këtë pjesë, e lë diskutimin në mes tyre. Kryetari, ndoshta ka mundësi ta dëgjoj atë që e thash sot dhe në takimin me grupin punues. OJQ Grapeland duhet ta mbështes projektin e filluar të komunës për ballkonin panoramik, pavarësisht çështjes se si ka ardhur deri te ideja e komunës dhe sot është e arsyeshme dhe e domosdoshme që projekti të përfundojë me shkronjat “Grapeland”, jo “Grapecity”. Besoj që komuna duhet të reflektojë prej nevojës dhe kërkesës së qytetarëve. Një kërkesë të shkurtër, si kryesues i kuvendit të kërkoj që në zonën ku ulen qytetarët, këtu prapa, anëtari tanimë i pavarur, Ilir Pallqa, i cili është anëtari më aktiv i zgjedhur prej organizatave monitoruese për 2023/24. Më dhimbset shumë që ka dalur prej LVV-së, në fakt, po më dhimbset Vetëvendosja që ka dalur Iliri. Besoj që duhet t’ia bëni një vend më të arsyeshëm dhe më komod, si anëtari më aktiv i kuvendit. Prej grupit të juaj, Dafina është zgjedhur anëtarja më aktive e femrave (grave) dhe ajo është shpërblyer.

Kryetari: T'ju them të drejtën e vlerësoj rolin e Ilir Pallqës, si dhe sot nuk e dinit si të ia bëni vendin, i thash le të ulet në vend timin. Iliri ka qenë aktiv, më së shumti më pëlqen që tani je me të vërtetë aktiv. Je pozitiv, konstruktiv dhe ke filluar të reflektoni në kuptimin më të mirë të fjalës. Iliri tani mund ta ndërron edhe cilësinë e të pavarurit, nuk ka asnjë problem, këtu ka edhe parti të tjera. E vërtetë që e ka dëmtuar Vetëvendosjen, e ka dëmtuar shumë, se jo pak. Albnori ka përgjigje të qartë për projektin. Jemi të lumtur që kemi arritur ta maksimizojmë në kuptimin e fitimit të një granti nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Nuk ka qenë e lehtë, sepse zakonisht thirrjet janë të kufizuara. Thirrja ka qenë për ballkonin panorakim dhe ne e kemi përshtatur projektin në bazë të kriterëve që janë të përcaktuara në thirrje. Unë mendoj që Rahoveci është vend unik edhe në ballkanin perëndimor dhe në botë, gjithashtu unik e ka edhe kryetarin e komunës. Nuk jam shumë mirë me anglishten, por, kam hulumtuar shumë dhe ishin shumë vende me emrin “Grapeland”, bile edhe në Serbi, në Spanjë, Amerikë dhe në shumë vende. “Grapecity” nuk e kam parë askund dhe pse mos ta ketë Rahoveci një “Grapecity”. Ne jemi duke bërë diçka që është shumë unike dhe esenciale është ta zhvillojmë me cilësi dhe kompetencë, që projekti të jetë i qëndrueshëm për atë qëllim që e ka. Do të ishte shumë më mirë që ta shkruanim shqip, por Rahoveci nuk është veç për Kosovën, është edhe për Shqipërinë, Mbretërinë e Bashkuar, për Francën e Gjermaninë dhe për të gjithë turistët e botës. “Njërit ia kishin marrë shtëpinë (pushtuesi), pronari thoshte që këtë shpuzore të cigares nuk do ta lëshoj”. Ju lus që mos të merreni shumë me shkronja, sepse projekti është duke ndodhur dhe do të ketë mundësi të bëjmë edhe revidime, por çështja e emërimit nuk është esenciale. Ne jemi të gatshëm t’i ndihmojmë Albnor Mullabazit që ky projekt të jetë më i qëndrueshëm dhe më krativ. Nuk dua të futem në histori, e dinë shumë mirë ata që janë takuar me mua, si dhe e dinë angazhimin tim që ideja të zhvillohet dhe jo të futet në arkivol, si Veton Surroi që e varroske dhunën e Serbia na vritke përditë. Ideja është dashur të zhvillohet. Për krahasim e kemi shembullin e kompleksit në Gradish, që ka qenë ide apo vepër e një ojç-je. Ata mendonin që duhet t’i zhvillojmë procedurat e prokurimit dhe mendonin që ne duhet t’ju japim paratë atyre etj. Atij projekti i ka prirë Dërvish Qadraku, të cilin e resptoju shumë. Ngjashëm ka ndodhur edhe në këtë pozicion. Albnori është djalë me horizonte të hapura dhe mirëpret arkitektë dhe kushdo që mund të ndihmojë gjatë procesit të korrigjimit të ndonjë elementi apo pozicioni. Ju mund të bëni edhe padi në gjykatë për pronësi, po e dini që veç që hargjoni duke e paguar avokatin, sepse rastin do ta humbni. E drejta e autorësisë i takon vetëm komunës. Mos bëni “zhurmë” për asgjë.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, të nderuar kolegë drejtorë, asambleistë. Të gjithë parafolësit e mi ia nisën me thënie, unë po ia filloj me fakte që i kemi gjetur në arkivë të urbanizmit. Idenë askush nuk ia mohon arkitektëve. Para tyre, në vitin 2004/20025 ka qenë edhe një ide tjetër. Një grup i studentëve ka ardhur në komunë dhe e kanë dorëzuar kërkesën dhe planin që lart të vendosen shkronjat “Rahoveci”. Në 2019 një ojç me emrin “Grapeland”, e ka bërë një projekt ideor, është takuar edhe me kryetarin e komunës. Ky grup ka bërë një kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit në emër të ojç-së ku është i përfaqësuar vetëm prej një anëtar, duke e kërkuar pronën që tanimë po ndërtohet projekti i ballkonit panoramik, të kalojë në pronësi të ojç-së. Më datë 13 prill 2019, nga Drejtoria e Urbanizmit është dorëzuar një njoftim dhe është kërkuar prej kësaj ojç-je t’i plotësojë dokumentat. Njëri prej kriterëve për plotësimin e dokumentave ka qenë edhe dorëzimi i projektit kryesor, që komuna ta realizojë të njëjtin. Në drejtim të drejtorisë asnjëherë nuk ka ardhur asnjë projekt kryesor. Komuna e Rahovecit në vitin 2022 ka filluar hartimin e një projekti tjetër me kompaninë projektuese dhe arkitektët që janë në komunë. Ky projekt tanimë po realizohet. Projekti ka dallim të madh me projektin që është prezantuar nga ojç “Grapeland”. Punimet janë duke shkuar shumë mirë dhe shpresojmë që brenda këtij viti të arrijmë finalizimin. Sa i përket emrin, ka spekulime. Për momentin është veç një emër, “Grapecity” dhe vazhdon me këtë emër. Nëse keni propozim për ndonjë ndryshim tjetër, siç e tha edhe kryetari, ne jemi të hapur për të gjithë.

Sejfullah Sejfullahu: Të gjithë ia nisën me thënie, po e nisi edhe unë. Është një thënie nga shkrimtari mitologjik, Sejfullah Sejfullahu: “Duajeni dhe vlerësojeni gruajën tuaj, pasi ajo ka lënë gjithçka dhe ka ardhur tek ti”. Këtë këmishë që e kam veshur, ma ka blerë 60 fr nga Zvicra. Mirë që u kthey kryetari. Një vërejtje të vogël e kam se qe 2-3 herë po përmendet prokuroria. Nuk është e mirë kjo, të gjithë këtu jemi shokë, miq e familjarë. Këtu fjalosemi e kur të dalim jashtë sallës e “dhezim” nga një të gjithë bashkë. Mendoj që asgjë nuk ka për prokurori. Si “katundar” i Krushës, po më vie inat që, nëse do të ishte “Grapeland” do të përfshihemi edhe ne, ndërsa si “Grapecity” më duket

mbetet veç Rahovecit. Kryetar, me një propozim jam bërë i mërzitshëm, sot e kam pyetjen e njëjtë për shtëpinë e masakrës në Krushë të Madhe, ku janë masakruar 64 vetë, apo siç e quajmë ne, shtëpia e krimatoriumit. Çka mund të bëjmë para se të fillohet me restaurim, apo ndërtim të atij muzeu? A ka ndonjë mundësi buxhetore?

Kryetari: Faleminderit Sefë! Kur përmendet prokuroria është e jona, institucionet janë tonat. Unë nuk e përmenda prokurorinë që ka diçka, por, nëse dikush mendon që ka diçka, atëherë janë adresat e duhura. Shtëpia e masakrës është në proces të shpronësimit. E dini historinë e asaj shtate, e kemi rifilluar procesin. Unë asnjëherë nuk e kam hequr kodin buxhetor, por nuk kemi arritur ta implementojmë për shkak të situatave të cilat janë. Nëse shpronësohet dhe gjithçka është në rregull, jam i bindur që Ministria e Kulturës dhe Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve do të kontribuojnë së bashku me komunën. Nëse nuk ka ndihmë nga askush, ne si komunë do t'i rrimë karshi të gjitha punëve. Aty është një vepër monumentale e kujtesës sonë kolektive. Faleminderit Sefë, jemi shokë e miq të gjithë.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarë të kuvedit, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë të Komunës së Rahovecit. Në seancën paraprake, drejtorit të Shërbimeve Publike ia kam parashtruar një pyetje, besoj që është në dijeni për përgjigje. Për Drejtorinë e Shëndetësisë, i kam dy çështje: Sa i përket QMF-së në fshatin Krushë të Madhe, kur pritet të funksionalizohet? Tjetra, rreth çështjes së barnatoreve që janë në kujdestari, a janë të përfshira të gjitha barnaret e qytetit? A është duke u respektuar orari? Sa i përket zyrtarit të gjendjes civile në fshatin Hoçë të Vogël, kur do të zëvendësohet, pasi ky i fundit ka dhënë dorëheqje për arsye personale!?

Saranda Sallteku: Faleminderit Lirigzon! Sa i përket renovimit të QMF-së në Krushë të Madhe, punimet aty do të përfundojnë brenda dy javëve dhe puna fillon me 1 nëntor. Sa i përket barnatoreve në qytet, në kujdestari janë vetëm barnaret që janë afër objektit të QKMF-së dhe janë gjithsej 7 barnatore. Orari besoj që po respektohet, janë edhe inspektorët e tregut që dalin në terren.

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë! Lirigzoni ka bërë pyetje rreth ndriçimit publik në fshatin Hoçë e Vogël. Aty KEDS-i ka bërë ndërhyrje dhe është bërë zëvendësimi i shtyllave të drurit në shtylla të betonit. Gjatë punimeve në disa lagje, fatkeqësisht e ka shkëputur edhe rrjetin e ndriçimit publik. Tutje, kompania Esko do të bëjë zëvendësimin e dritave digjitale në fshatin Hoçë e Vogël dhe Brestoc.

Lirigzon Kastrati: Është e vërtetë që kompania ka qenë dhe i ka bërë disa ndërhyrje, ne momentin që i kemi kërkuar edhe disa ndërhyrje të tjera, ata thanë që nuk kemi përgjegjësi më. Për dëmet e shkaktuara a do ta bëj rikthimin KEDS-i, apo përgjegjësia do të bartet e gjitha tek ju, realisht kompania e kontraktuar.

Përparim Krasniqi: Ne i kemi dy kompani. Një kompani që kujdeset për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe tjetra që bën zgjerimin e ndriçimit publik. Pas dëmtimeve të KEDS-it e kam dërguar kompaninë që t'i riparojë sanimet për aktivizimin e ndriçimit publik. E kemi kompaninë e veçantë për mirëmbajtje.

Ilir Pallqa: I nderuar kryesues, kryetar, kolegë asambleistë, drejtorë, të pranishëm në sallë. Kohët e fundit, kolegut tonë, Drilon Mustafës i është punësuar një familjar shumë i afërt. Sot po flas për një vazhdimësi, fundi i së cilës ende nuk po shihet. Pas “këndimit” të vazhdueshëm, pason “bakshishi”. Në komunë, vetëm në këtë mandat janë punësuar 5 familjarë të asambleistëve të Aleancës. Gjithashtu, 5 asambleistë të zgjedhur kanë liruar pozitat për punësim personal. Unë për vete do të frikohesha t'i punësojë kështu njerëzit, pa të drejtë. Sinqerisht, po i hyjmë në hak atyre që kalojnë sfida dhe bëjnë përpjekje të vazhdueshme për studim e dije. Në fund, varësisht prej këngës vazhdon ecuria e njëjtë e punësimeve, demolim. Nuk ka hajr kur dikujt i bëhet padrejtësi. Në këtë gjendje nuk jemi kot, si shtet dhe si komunë. Mund të tingëllojë edhe si fushatë, por në Pejë ka ndodhur një fenomen jo i mirë. Një vajze me shami është duke iu cenuar mësimnxënie, ajo është 18 vjeçare. Ministrja e Arsimit, në vend që të merret me reforma ligjore e rregullatore për konkurse, për meritokraci dhe për atë që ne dikur jemi thirrur dhe që mos të vazhdojë ky cikli i punësimeve, si puna e Drilonit, që i bën kryetari i komunës dhe të gjithë kryetarët e komunave nëpër Kosovë. Njëjtë vepron edhe qeveria. Ajo vazhdon të merret me mbajtjen me çdo kusht të një udhëzimi administrativ diskriminues. Kur dikush bën padrejtësi në mësimnxënie, çka të presim në mësimdhënie. Kjo është Kosova jonë e nderuar, që historikisht i është bërë padrejtësi dhe sot turpërohet për padrejtësitë që po i bën kasta politike brenda vetes. E kam edhe unë një thënie shqip: “Dikur lart thirrnin për ndryshim, poshtë për vazhdimësi – diku terr e diku zi”.

Kryetari: Tani e kuptova arsyen se pse je larguar nga subjekti politikë që i ke takuar deri tani. E vërteta është që ka punësime me të gjitha procedurat e rregullta dhe nuk kanë të bëjnë me aspekte kundërligjore. Më besoni që nuk ka kandidatë dhe në shumicën e konkurseve konkurron vetëm një, përveç konkursit për infermieri që ka shumë. Te udhëzimet administrative, nëse ju ka premtuar dikush ndryshe dhe nuk e ka mbajtur fjalë, atëherë unë nuk jam fajtor. Përderisa ka qenë Ministër i Arsimit, Lika, Ramë Buja etj... librat i kanë dorëzuar në DKA për t'i shpërndarë te nxënësit, tani askush nuk din saktë a blehen librat apo jo. Nëse i merr dikush paratë për libra, kjo nuk do të thotë që blen libra, paratë mund të përdoren edhe për qëllime të tjera. Është viti i dytë që ne kemi situatë sfiduese me maltretimin e prindërve dhe nuk ia kemi pasur borxh Ministrisë së Arsimit që të na krijojë këto situata të palakmueshme. Bashkohem me shqetësimin tënd, Ilir Pallqa.

Eqrem Spahiu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Kryetari më herët të mos merremi shumë me zhurmë dhe shkronja. Nuk do ta bëjmë këtë gjë, por do ta ngris një shqetësim: Para 10 dite është mbyllur AMF-ja në fshatin Opterushë. Në terren duhet të dalim para se të bëhen këtë gabime, sepse më pas kushtojnë më shumë. Preteksti për mbylljen ka qenë defekti i kanalizimit. Aty është defekti i të gjitha punimeve, nga fillimi në fund.

Kryetari: Besoj që jeni në dijeni rreth diskutimeve të bëra rreth QMF-së në Opterushë. Askush nuk ka thënë që ka problem veç të kanalizimit, aty ka problem me ujëra-lagështi. Shpresoj që shumë shpejt do të kemi procedurë të prokurimit dhe do të përmbyllet me sukses ai defekt që është si pasojë e ujrave, të cilat shkaktojnë lagështi. Përndryshe, gati çdo ditë kam qenë në Opterushë me inxhinierë të komunës. Besoj që do të ketë epilog pozitiv edhe QMF-ja në Opterushë.

Vlora Vuçiterna - Çmega: Përshëndetje për të gjithë! Po ndërlidhem me atë që tha Iliri, i cili harroi të cekë që së fundmi, në konkursin e infermierisë është pranuar edhe një tjetër i juaji. Është fjala për vajzën e drejtoreshës së çerdhës "Tulipanët". Nuk kam asgjë kundër kësaj, i uroj shëndet dhe suksese, por e ndërlidha me atë që ju jeni duke i punësuar veç njerëzi e juaj, përkundër përvojës 6 mujore që e ka pasur ish mësimdhënësja me inicialet M.S. E kam edhe një pyetje për drejtorin e Financave në cilësinë e kryesueses së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, e kam kërkesë t'ju pyes se çka po ndodh me pagesat tona. Ka një vit që anëtarët e komitetit nuk paguhen, përkundër kësaj ne vazhdojmë ta bëjmë punën tonë. E udhës është që pagesat të kryhen, duke pasur parasysh që aty ka edhe anëtarë të shoqërisë civile. Nëse është problemi që unë jam pjesë e VV-së, atëherë po tërhiqem, veç le të kryhen pagesat për të tjerët.

Kryetari: Mezi kam pritur që të paraqiteni në testin me shkrim Vlorë, jam interesuar dhe nuk jeni paraqitur. Një herë keni aplikuar dhe tani nuk jeni paraqitur. Lëvizja Vetëvendosje është parti e quditshme, më duket që ju duhet ta pyetni Albin Kurtin për t'u punësuar në komunë. T'ju them të drejtën Iliri po më pëlqen, është më autonom. Kam pritur që të paraqitesh aty, ishe punësuar dhe askush nuk do ta përmendte. Nuk ka konkurrencë, ti e din që kanë qenë vetëm dy. Kur flasim për të tjerët, duke përdorur inicialet e herë emra, duhet të themi, a thua pse nuk u punësova edhe unë!? Këtu është problemi, prandaj më vie keq, sepse fatin e Ilirit do ta kenë edhe shumë të tjerë. Unë mendoj që ti e ke humb një shancë të panevojshme në përputhje të plotë me ligjin. Sa i përket punësimeve, mos u ngutni, sepse unë mund ta kem një listë që do t'ju bëjë të thoni që: "pse fola", bile në kohën sa jam unë kryetar janë punësuar shumë njerëz që nuk kanë lidhje as me zgjedhje, as me vota. Qëndrojmë shumë mirë në aspektin e ushtrimit të mandatit.

Vlora Vuçiterna - Çmega: Faleminderit kryetari për vlerësimin si farmacistë që jam. Si të kandidoj unë, kur më vijnë ofertat që të kaloj në parti të juaj dhe të punësohem në atë vend pune!

Kryetari: Nga unë?...

Vlora Vuçiterna - Çmega: Nga ju direkt jo, por nuk po i përmendi se nga kush. Nuk është e karakterit tim që të kaloj në parti tjetër veç për një punë. Githashtu edhe sikur të jem e papunë, nuk do ta bëja. Mos të harroj ta cekë se edhe një herë kam qenë e vetmja kandidate për konkursin e infermierisë, konkursi është anuluar me arsyen që nuk ka kandidatë të kualifikuar për atë pozitë.

Kryetari: Zakonisht kur po përmenden punësimet, e di që të gjithë ju keni punë me mua. Mendoni që unë jam alfa dhe omega, supermeni etj etj... Unë nuk marr përgjegjësi që të tjerët të thonë "a po vjen në parti", por nuk është asgjë, unë tash të them, a po vjen në parti? Ose shko në PDK. A e sheh sa i thjeshtë jam! Konkursi që e përmende është anuluar në mungesë të dokumentacionit, sepse kandidatët nuk po i vendosin të gjitha dokumentat e kërkuara në sistem.

Të ftoj të reflektosh dhe mos u merr me ata që të thonë “hajde në parti, gjithashtu mos u merr edhe me ata që përpiqen të të mbajnë në “kontrollë”.

Defrim Kafexhiu: Dua të përfshihem te debate me Vlorën, por paraprakisht për atë që diskutoi Iliri. “Rreh ku është më butë” Iliri dhe kryetari e gjetën një pikë të përbashkët dhe po e godasin nivelin qëndror. E keqja e sistemit arsimor nuk është as Arbërie Nagaci e as Qeveria Kurti. Është kompetencë e nivelit komunal për rekrutimin e mësimdhënësve. Kjo kompetencë nëpër çdo komunë e ka shkatërruar sistemin arsimor dhe e ka bërë të jetë në këtë nivel. Kryetari tha që janë “gjynah” ata fëmijë e prindër që janë maltretuar duke pritur në radhë në librari për t’i siguruar librat. Unë them që është “gjyna” për një student që i ka përfunduar studimet, masteri, praktikën dhe në fund nuk mund të punësohet, sepse në punë futet dikush nga Aleanca. Kryetari i tha Vlorës që i ke plotësuar kriteret për konkurs, në fakt kryetari nuk është anëtar i komisionit. Kryetari e bën vendimin për themelimin e komisionit, komisioni e vlerëson kandidatin. Kjo është mendësia që neve si komunë po na penalizon edhe në nivelin arsimor që e kemi kaq të ulët. Ne nuk e kemi problem edhe të futemi në vlerësim apo procedura të rekrutimit, por tani njerëzit më shumë frikohen të pranohen, sesa të mos pranohen në institucione publike, sidomos ata që merren me politikë. Unë besoj që kryetari është alfa dhe omega e punësimeve në Komunën e Rahovecit. Nuk besoj që një punësim kryetar, duke mos e ditur kryetari i komunës, duke e përfshirë edhe këtë të fundit të Drilon Mustafës edhe pse nuk ka pasur kundërkandidatë kandidatja e pranuar. Gjithashtu edhe në konkursin paraprak në shëndetësi ku janë punësuar 17 vetë, këtu edhe lista e pritjes është bërë me intervenime.

Kryetari: Unë jam alfa dhe omega, por në zbatim dhe në përputhje të ligjit. Asnjëherë nuk jam përzier në organe profesionale, kompetente që janë. Nëse ka pasur ndonjë situatë sfiduese, është marrë inspektorati i arsimit. Politikat që i përfaqëson LVV-ja njëmend janë të quditshme, mënyra se si funksionojë sot është pakrahasimisht më e dobët siç ka qenë. Për shembull, Defrimin e cilësoj si këshilltar special, pa pagesë, sepse më ndihmon ndonjëherë të luftoj me vetveten dhe të reflektoj në rast nevojë. Konkursi është publik dhe nëse konsiderohet që ka dyshime, çdo kush e ka të drejtën e ankesës. Mos harroni që ka deficit në matematikë, fizikë dhe në disa shkenca ekzakte. Është e vërtetë që kryetari nuk merr pjesë në rekrutim dhe është e vërtetë që kryetari e nënshkruan komisionin për vlerësim, por gjithashtu është e vërtetë që kryetari nuk është duke jetuar në “Hon-Kong”, por në Rahovec, i cili është vend i vogël dhe natyrisht që kryetari ndonjëherë e merr informatën që ka konkurruar dikush, apo edhe që nuk ka shkuar në test.

Melinda Oruqi Iska: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë. E kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: Drejtor, është hera e tretë që jam duke bërë kërkesë për rrugën “Xhafer Nurkasa”, e cila është në gjendje të mjerueshme.

Avni Morina: Përshëndetje për kryetarin, kryesuesin, nënkryetarin, kolegët drejtorë, asambleistët. Dëshiroj t’i përgjigjem asambleistit Faton Ramadani në dy pyetjet e tij. E vërteta është që nuk kemi mungesë të fotokopjuesve nëpër shkolla, por, kemi mungesë të kujdesit për funksionimin e tyre të rregullt. Jemi duke u munduar të intervenojmë edhe përmes zyrtarit për IT që të përmirësohen shërbimet. Sa i përket nyjeve sanitare, ju Faton aty punoni, por, sot e dëgjova nga ti që nxënësit shkojnë në shtëpi për t’i kryer nevojat personale. Nuk ka tre muaj që i kemi rregulluar nyjet sanitare, kuptohet jo në mënyrë complete, por elementet e nyjeve sanitare që kanë qenë të domosdoshme. Nga drejtoria e shkollës kemi pasur kërkesë që të kalohet në një ndërrim dhe të bëhet zvogëlimi i klasave apo ndarja, këtë gjë e kemi kryer dhe kanë mbetur edhe që të pajisen me dyer. Vlorën e kam pasur nxënëse një kohë dhe më ka ardhur keq që nuk ishe në testim me shkrim, sepse ndoshta do të ishe e pranuar. Nga koha kur keni aplikuar, deri te dita kur është mbajtur testi me shkrim, nuk ka më shumë se një muaj. Të them të drejtën është e quditshme të ndërrohet mendja kaq shpejt. E falënderoj kandidatin tjetër që është paraqitur, sepse është dashur që konkursi të anulohet. Përndryshe, konkurset që shpallen në IAAP janë të përkohshme, sepse ne nuk mund t’ju bëjmë kontratë të përhershme punëtorëve në një shkollë profesionale ku drejtimet profesionale merren me vendim çdo vit nga Ministria e Arsimit. Në qoftëse sivjet ka pasur infermieri dhe farmaci, vitin e ardhshëm mund të mos ketë. Në konkursin tjetër që ka qenë, ishin tre kandidatë dhe të them të drejtën askush prej tyre nuk e ka pasur gradën master, atëherë është marrë për bazë edhe nota mesatare edhe puna në test dhe në intervistë. Në konkurset e DKA-së çdo kandidatë ka të drejtë të konkurrojë dhe pas një muaji ne nuk i vonojmë procedurat sikurse në komuna të tjera, si Prizreni që më shumë se dy javë është mbyllur afati i aplikimit dhe ende nuk i kanë thirrur kandidatët për intervistë me shkrim. Meqenëse vajzën time nuk po mundem ta punësojë

këtu, ka aplikuar në Prizren dhe ende nuk e kanë thirrur për intervistë, kanë kaluar dy javë. Te ne, maksimum pas dy ditëve i thërrasim kandidatët për intervistë, si dhe pas përfundimit të intervistës me shkrim, çdo kandidatë ka të drejtë ta rishikojë testin.

3. Shqyrtimi dhe miratimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.235/24 i datës 25.07.2024 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Para jush keni vendimin i cili duhet të rishqyrtohet, me kërkesë të zyrtarëve ligjorë të MAPL-së, për shkak të pikës 1 të vendimit. Pika 1 e vendimit thotë: Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr.235/24 i datës 27.07.2024 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik. Pika 2 thotë: Pika 1 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim: Me këtë vendim shpallet me interes të përgjithshëm publik ndërtesa administrative në sipërfaqe 200m²-e evidentuar në emër të KB Bujku, Drenoc, Rahovec, ndërtesa gjenden në parcelën me nr. 00041-1. Bëhet fjalë për objektin e shtabit të UÇK-së në Drenoc, me sipërfaqe të njëjtë dhe me këtë numër të parcelës.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi ndonjë gjë rreth kësaj pike, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (15) aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pauzën e drekës...

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2025;

Afrim Limani: I nderuar kryesues, kryetar, asambleistë, kolegë drejtor, të nderuar të pranishëm. Buxheti i Komunës së Rahovecit sipas qarkores së dytë buxhetore ka pësuar ndryshime në disa kategori ekonomike, në raport me qarkoren e parë buxhetore. Në emailat e juaja e keni edhe qarkoren e dytë buxhetore. Buxheti përfundimtar i Komunës së Rahovecit për vitin 2025 është 20.982.000€. Në pozicionin e pagave janë 10.746.000€, mallra dhe shërbime 2.761.000€, komunalit janë 390.000€, subvencione 1.010.000€ dhe pjesa e investimeve kapitale është 6.075.000€. Para vetes i keni dy dokumente, dokumentin e parë: shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike sipas programit, si dhe listën e projekteve kapitale për vitin 2025-2027. Numri i projekteve është 44, prej tyre janë 37 projekte në vazhdim dhe 7 projekte të reja. Në kuadër të këtyre projekteve kapitale, gjatë dëgjimeve buxhetore mbi 90% e kërkesave të qytetarëve janë të involvuara. Ndoshta në kuadër të kësaj liste nuk kemi pasur mundësi t'i emërtojmë të gjitha projektet, mirëpo besoj që e keni parë përmbajtjen e projekteve sipas investimeve kapitale. P.sh: Te ndërtimi i rrugëve, ju e keni listën se ku do të ndërtohen këto rrugë. Totali i buxhetit për investime kapitale për tri vitet e ardhshme është 19.100.000€. Kjo i bie që në raport me obligimet kontraktuale jemi në përputhshmëri të mjaftueshme. Kërkoj nga ju që ta votoni këtë buxhet. Është buxhet për qytetarët e komunës tonë.

Hasan Përboqi: Faleminderit! Përsëritje kryetar, kryesues, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë, media. Më lejoni të paraqes qëndrimin tonë si grup i Aleancës në lidhje me projekt-buxhetin për vitin 2025, që ka ardhur nga ekzekutivi. Votimi i buxhetit është moment i rëndësishëm, ku ne, të zgjedhurit e juaj e kemi mundësinë që besimin tuaj ndaj nesh ta kthejmë ashtu siç ju e meritoni. Pra, t'i mbështesim me votë, ashtu siç e kemi marrë besimin tuaj projektet që ndikojnë direkt tek ju. Në këtë projekt-buxhet ka projekte që janë në vazhdim dhe janë disa projekte të reja. Po i përmendi disa projekte që janë shumë të rëndësishme, që ndikojnë në zhvillimin e qytetit: Sheshi qëndror, ka filluar të realizohet dhe për vitin 2025 janë të planifikuar 1.350.000€. Në mendjen time, ky duhet të jetë projekti më i madh që është buxhetuar ndonjëherë në historinë e Komunës së Rahovecit. Pastaj e kemi ndërtimin e objektit të ri të shkollës në fshatin Xërxë, i cili është në projekt në vazhdim dhe është buxhetuar me 350.000€, me 250.000€ është buxhetuar ndërtimi i shkollës fillore në Ratkoc, zona ekonomike është projekt që bashkëfinancohet me Ministrinë e Tregtisë dhe është buxhetuar me 90.000€. Kjo zonë do të ndikojë direkt në bizneset që do të operojnë në atë hapësirë. Projekt i ri është rruga “Ibrahim Rugova”, “Xhelal Hajda” dhe “Muharrem Dina” që lidhen direkt mes sheshin qëndror dhe ndikojnë shumë në lirin e komunikacionit në qytet. Ne si grup jemi të vetëdijshëm që kërkesat për rrugë dhe investime janë shumë më të mëdha se sa këto që janë të parapara në këtë buxhet. Gjithashtu jemi të vetëdijshëm që edhe mundësitë buxhetore të komunës janë të kufizuara. Kemi edhe kontrata që janë në realizim e sipër dhe sipas ligjit për financat publike e dimë që komuna si institucion është e obliguar që së pari të sigurojë mbulim buxhetor për këto projekte dhe tutje të mendojë edhe për projektet që do të fillojnë së implementuari. Të nderuar qytetarë, vota jonë si grup do të jetë “për” miratimin e buxhetit dhe po ashtu i ftoj edhe kolegët asambleistë që ta bëjnë veprimin e njëjtë.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Fillimisht është e njëta rrethanë që ka qenë edhe më herët, projektet janë të përgjithësuara dhe nuk kemi projekte specifike sa i përket kodeve buxhetore. E tha drejtori që përshkak të pamundësive për t’i bërë e keni dërguar një listë të zotimeve se çka do të bëhet. Lista e zotimeve, realisht është më shumë dëshirë se sa mundësi. Nëse e krahasojmë ndërtimin e rrugëve në Komunën e Rahovecit, që në vitin 2025 e kap vlerën prej 350.000€ dhe në raportin financiar janar-qershor 2024 keni raportuar që kontrata të mbetura në investimin e rrugëve në Komunën e Rahovecit janë me vlerë 620.000€. Do të thotë që buxheti i vitit 2025 nuk e përmbush as 50% të obligimeve që janë të trashëguara nga 2024. Nuk është përmbushje reale e mundësive financiare për t’u realizuar kjo kontratë. “Investime në mirëmbajten e hapësirave publike - varrezave” është zero në tabelar, nuk e di pse! Kodi 48189 është vazhdim – furnizim me gypa pvc është zero zero. Kodi i “izolimit të objektit të zjarrfikësave” është zero zero në tabel. Kodi i projektit “ndërtimi i infrastrukturës në tregun e rrushit, në 2024 është 50.000€, 2025-2026-2027 nuk është asnjë cent! “Ndërtimi i serrave me participim” në tabelar nuk është e paraparë asnjë euro. “Përkrahje e fermerëve me mekanizëm bujqësor” është zero zero. Kodi 47865 “stalla dhe ferma të vogla për fermerë” është zero zero. “Ndërtimi i kanalit të kullimit të tokave” në Fortesë dhe Celinë, përpos 40.000€ që janë në 2024, nuk ka asgjë në 2025, 2026, 2027. “Ndërtimi i shtandeve, tezgjeve për mbajtjen e panairëve” në 2024 janë 37.900€, ndërsa viteve tjera nuk ka asgjë. Te “mbikëqyrja e punimeve” nuk janë të parapara asnjë euro – kodi 40838. Te “hartimi i projekteve” nuk është asnjë euro – 40839. “Renovimi i ndërtesave, objekteve publike – fasadimi” nuk është asnjë euro. Te “Riparimi i shkollave” ka buxhet, por nuk është i specifikuar. Kur e shikojmë në të përgjithshmen, nuk janë kryesisht kode të reja buxhetore, por janë kode që janë në vazhdim sepse janë punët që kanë filluar edhe më herët, këtu vetëm ka mbetë si e tillë. Një pyetje që iu kam drejtuar juve në KPF dhe që e kemi marrë një gjysmë arsytimi për sheshin qëndror. Ndërtimi i sheshit qëndror ka kontratë 3.817.347€. Në vitin 2022 keni paguar 180.000€ dhe kur i mbledhim të gjitha me këtë buxhet të paraparë, del që kontrata e sheshit qëndror bëhet 4.210.000€. I kemi 392.652€ më shumë se sa kontrata fillestare. Kjo gjendje e ka tejkaluar 10% e lejuar për punë shtesë dhe ende nuk jemi në 50% të realizimit të punëve të projektit. Kur e krahasojmë buxhetin dhe zotimet që janë drejtuar, rruga Rahovec – Senoc – Drenoc – Pastasel - Polluzhë do të mbetet e tillë, nuk do të ketë investim. Rruga, Fortesë – Pataqan i Ulët – Pataqan i Epërm që e lidh rrugën për Drenoc dhe që është në gjendje të mjerueshme, nuk parashihet të investohet diçka në të. Rruga, Ratkoc - Vranjakë – Brototin që shkon për Drenoc është në gjendje të mjerueshme, përpos urës që është pjesë e zotimeve. Për neve si LDK është e paqartë forma e buxhetimit, ka mospërputhje të madhe dhe zotimet nuk kanë mundësi të realizohen absolutisht. Ka shumë kode buxhetore pa mjete financiare. Buxheti i sheshit qëndror ka dallim të madh me kontratën fillestare. Buxheti është i papranueshëm, nuk ka arsyeshmëri të mjaftueshme dhe grupi i asambleistëve të LDK-së nuk e përkrah këtë buxhet.

Edona Kryeziu: Përshëndetje për të gjithë! Nuk kam diçka të veçantë në lidhje me buxhetin. Pajtohem me të gjitha ato që i përmendi shefi i grupit tonë. Ajo që më ka rënë në sy është te “subvencionimi me mekanizma bujqësorë, me participim” nuk është i vendosur në investime kapitale.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit i nderuar kryesues! Të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit, qytetarë. Pajtohem plotësisht me deklaratimet që i bëri shefi i grupit, Burim Krasniqi. Në vazhdimësinë e kësaj qeverisjeje, ky buxhet tregon qartë që nuk do të jetë buxhet zhvillimor për qytetarët e komunës sonë. Po fokusohem kryesisht nga vendi që përfaqësoj. Shtrati i lumit që mbulon fshatrat: Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe, është një projekt i stërzgatur me vite të tëra dhe pa ndonjë epilog. Kolektori i kanalizimeve është i njëjti, i papërfunduar dhe jashtë funksionit, përkundër që mjetet janë paguar. Nuk mund ta përkrahim një buxhet, me të cilin qytetarët përsëri kanë telashe me kanalizim dhe nuk kanë qasje në kolektor. Kërkesë e vazhdueshme e fshatratve Hoçë e Vogël dhe Brestoc është uji i pijshëm. Ka kërkesa të vazhdueshme për rrugë fushore dhe gjatë këtyre tri viteve nuk është bërë asnjë investim. Ndriçimi publik është i njëjti, me kërkesa të vazhdueshme dhe pa zgjidhje deri më tani. Lagjet kanë mbetur pa ndriçim publik dhe ato që e kanë pasur nuk është ofruar rikthimi – kërkesa të paraqitura me vite të tëra. Për rregullimin e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Hoçë e Vogël e kemi bërë një kërkesë që vazhdimisht duhet të intervenohet dhe së paku të vendosen ndonjë pllakë. Në buxhet nuk e vërejtja ndonjë zotim që e keni për këtë çështje. Raporti i ZKA-së tregon qartë që ka pasur shumë vonesa në realizimin e projekteve si dhe projektet e filluara kanë qenë pa mbulueshmëri financiare.

Kryetari: Ndihem shumë mirë që bashkë me ekipin tim jemi këtu në kuvend të komunës, që ta paraqesim projekt-buxhetin për vitet 2025-2027. Ky projekt i buxhetit ka ardhur si rezultat i analizave jo vetëm nga drejtorja e Financave, por edhe si rezultat i takimeve të shumta me qytetarë të shumtë, që ka asambleistë këtu që as që kanë dashur të dëgjojnë ndonjëherë për të marrur pjesë në dëgjime buxhetore. Drejtori i financave dhe Hasan Përboqi thanë që sot është vendimi më i rëndësishëm për një asambleistë dhe një komunë. Përmes votimit të buxhetit ne kontribuojmë drejtpërdrejt ose tërthorazi në kërkesa të qytetarëve, duke u bazuar në kufizime buxhetore. Në raportin e fundit të institutit GAP – i cili i evidenton zotimet e kryetarëve të komunave dhe nga 84 premtime, 53 janë të përmbushur, 21 janë gjysmë të përmbushur, 8 të filluara dhe 2 janë ende të pafilluara dhe kjo dy të fundit nuk varen nga pushteti local. Pra, çdo gjë që është përtej këtyre kornizave, ose është artificiale ose është fushatë për 2-3 vota më shumë, apo më pak. Mandat zyrtarisht kemi edhe një vit e dy muaj dhe gjejeni edhe ndonjë komunë tjetër që i përmbushur premtimet si ky që e kenë para vetes, Smajl Latifi me ekipin e tij. Ju lutem, duhet ta kuptoni se çka është investimi kapital, mekanizmi bujqësor nuk është investim kapital. Sipas auditorit, mekanizmi bujqësor është subvencion. Ju kujtoj që Afrim Limani do t'ju përgjigjet për aty që nuk figuron buxheti. Parimisht ju them që ne kemi një plan të prokurimit që zakonisht sipas kërkesave ligjore miratohet për një vit. Mos e harroni faktin që mekanizmi bujqësor është larguar, vetëm kodi ekziston, por tani kemi filluar me inpute bujqësore, pleh kimik dhe farëra të ndryshme. Serrat nuk janë më investime kapitale, por vetëm subvencione. Subvencionet janë rritur dhe janë bërë 1010.000€ dhe nuk e di pse duhet t'i riaktualizojmë temat që i diskutuam në pikën e dytë të rendit të ditës. Shtrati i lumit, Hoçë e Madhe – Brestoc, Hoçë e Vogël – Nagac deri në Krushë të Madhe, ka kontratë dhe nuk është vetëm shtrati i lumit, por edhe kolektori i ujërave të zeza. Operatori është duke punuar, veç nëse tani e ka ndërprerë për shkak të reshjeve, përmdryshe e ka bërë pastrimin dhe tani fillon me betonim. Ndrëçimi publik, Përparimi tregoi që janë dy kompani, njëra mirëmban ndrëçimin ekzistues dhe tjetra zgjeron ndrëçimin publik. Do të ndërrohen dritat dhe do të fillohet me process të zgjerimit në të gjitha lagjet ku mungon. Krahasoju ato dy vendbanime ku kanë qenë para dy vjetëve dhe ku janë sot. E vetmja komunë jemi që mirëmbajmë varreza të dëshmorëve, martirëve dhe të civilëve. A mirëmbahen mirë? Ndoshta edhe ndonjëherë jo! A ka nevojë për ndonjë kubëzim? Po, ne e kemi një kontratë për varreza, lapidare etj... Kjo kontratë është në zbatim. Kuptojeni faktin që, kompetencat për ujën e pijshëm pothuajse të gjitha i takojnë KRU Gjakovës. Ju zotohem publikisht që nëse KRU Gjakova në ambiciet e veta e ka ujësjellsin Hoçë e Vogël – Brestoc, ne jemi të gatshëm të participojmë me 49%. Ne jemi vetëm participues në projektet që lidhen me ujësjellsin. Jemi të obliguar t'ju themi që gjithashtu mirëmbajten e kanalizimit e ka KRU Gjakova. Të bëhemi pak më serioz në fjalime, nëse jep vërejtje përpiku pak ta argumentosh. Te sheshi qëndror, ju e dini që është larguar trafoka ka pasur kontratë mbi 70.000€. Në kuadër të këtij shtesë kemi edhe një rrugë qarkore dhe një urë që e kemi futur me grant të performancës, e cila e ka rritur çmimin e përgjithshëm. E rëndësishme është që sheshi do të bëhet dhe do të bëhet më shpejt se sa që kemi para ta paguajmë. Në kushte normale do t'i japim fund në fund të vitit 2025. Mbulimin e projekteve e mendojmë edhe me pozicion të të hyrave, me barte të të hyrave. Sa i përket vlerave zezo zero, me plan të prokurimit i cili votohet në kuvend, vlerat vendosen vetëm te kapitalet dhe jo edhe te subvencionet dhe te mallrat dhe shërbimet. Nëse nuk kemi vendosur asnjë vlerë për serra, ne e kemi nënshkruar kontratën për serra dhe mjetet i marrim nga subvencione. Kontratat ekzistojnë, janë valide dhe besoj që është në rregull. Buxheti është ky që është dhe gjysma e tij është për paga, mos të harrojmë që pak jemi dëmtuar nga kontrata kolektive, që nga kjo e fundit është kualifikuar edhe raporti i ZKA-së. Kryesisht për kontratë kolektive janë kualifikuar 22 komuna që udhëhiqen nga shqiptarët edhe pse në kontratë kolektive, neni 8 thotë që ata duhet ta mbulojnë. Në buxhet i kemi marrur edhe kërkesat e dëgjimeve buxhetore, gjithashtu analizat vazhdojnë edhe në departamentin për buxhet, pastaj e kemi një drejtor me përvojë. Një kompleks mermoria e meriton Retija, prej mandatit tim të parë jam duke luftuar që atje të jetë një kompleks. Kode të reja nuk ka, përveç atyre dy kodeve të cilat i përmenda, Retijën dhe buxhetimin me pjesëmarrje. Pas këtyre sqarimeve, sigurisht do të flasim edhe tjerët, ju ftoj ta miratojmë buxhetin për vitin 2025. Jam i vetëdijshëm që është buxhet në shpërputhje me nevojat e qytetarëve të komunës, por, gjithsesi është në interes të tyre dhe përmes punës tonë aktive dhe dinamikave të larta të fitojmë edhe buxhet shtesë.

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje edhe një herë! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit komunal. Është hera e tretë në këtë mandat që jemi në seancën e shtatorit dhe realisht është seancë e buxhetit. Në

aspektin politik, nuk është që i jap shumë rëndësi çështjes së votës për miratimin e këtij propozimi të ardhur nga ekzekutivi. Ky është buxhet politik. Këtë e them për shumë arsye, duke filluar edhe prej këtyre premtimeve, që kryetari thotë që 53 janë të përmbushura prej 84, sipas institutit GAP. Ju drejtohem qytetarëve dhe të gjithë ata që i kanë besuar Smajl Latifit për udhëheqjen e mandatit të dytë radhazi dhe të tretin në përgjithësi si kryetar. Është standart i njëjtë dhe shabllon i njëjtë i implementimit të buxhetit që nga mandati i parë edhe pse kanë kaluar 15 vjet që kur Smajl Latifi për herë të parë ka qenë kryetar i komunës. Ky standart i njëjtë nuk ka ndryshuar, për këtë arsye te unë dhe te grupi i LVV-së nuk kemi shpresa të implementimit të buxhetit që Komuna e Rahovecit do të shoh ndonjë zhvillim të caktuar në cilatdo prej fushave. Implementimi i buxhetit fillore prej qarkores së parë, duke filluar me takime me qytetarë sipas kërkesave që ata ia bëjnë grupit punues, drejtorit dhe kryetarit të komunës, përmes takimeve dhe në formë elektronike. Nëse i marrim procesverbalet e dëgjimeve buxhetore, duke filluar nga viti 2021 shohim që ka kërkesa të njëjta të qytetarëve. Për mua është nonsens nëse një kryetar i këshillit të një fshati e ka bërë një kërkesë në 2021, është cilësuar si e aprovuar prej grupit punues për implementimin e buxhetit, të njëjtën kërkesë e ka bërë edhe në 2022, në 2023 dhe në 2024 dhe kërkesa vazhdon të jetë e njëjtë për një çështje jetike, siç është shtrimi i një rruge, çështja e kanalizimit apo ndriçimit publik. Pra, është formë që e ka mësuar ky ekzekutiv. Vërejtjet tona do t'ia dorëzojmë edhe institutit GAP për çështje të kriterëve. Te projektet e reja që janë të caktuara këtu në këtë projekt-buxhet dhe realisht janë vetëm dy projekte. Buxheti me pjesëmarrje është një projekt kreativ dhe më i miri, që qytetarët janë të përfshirë drejtpërdrejt. Përndryshe është edhe një projekt i ri, ndërtimi i qendrës përkujtimore në Retijë. Projektet tjera vetëm janë emërtuar si të reja, sepse absolutisht nuk janë të reja. Vendosja e ashensorit në objektin e ndërtesës së komunës nuk është projekt i ri. Ndërtimi i rrugëve në hapësirat për biznese dhe turizëm, nuk është projekt i ri, sepse paratë naj ndarë edhe më herët për këtë projekt. Pastaj, prej mandatit të parë të Smajl Latifit prioritet qeverisës është agroturizmi. Për agroturizëm, qeverisja e Smajl Latifit kurrë nuk ka bërë diçka. Arsyetimet i japin në shtrimin e rrugëve fushore. Rrugët fushore nuk kanë lidhje me agroturizëm, duke mos qenë një projekt i mirëfillt dhe i mirëmenduar. Kanë kaluar tre mandatet të Smajl Latifit dhe njerëzit përballen me nevoja jetike dhe esenciale. Është çështja e tensionit të energjisë elektrike që është në dy lagje në Komunën e Rahovecit. Jemi në vitin 2024 dhe jemi duke e implementur buxhetin për vitin 2025 dhe ka shtëpi pa kanalizim në qytet. Përderisa, me një krahasim shumë të thjeshtë atje po e vendosim një monument “Grape City” dhe në një “City” minimalisht duhet të jenë shtëpitë me kanalizim. Përmes këtij buxheti, sikur vitet paraprake, sikur çdo buxhet tjetër, nuk është marrë një hap i dukur të zgjidhet problemi i tensionit të energjisë elektrike, e di që këtë gjë e bën KEDS-i, por prona mund të ndërrohet. Në projekt-buxhetin e vitit 2020-2021 ka qenë kodi buxhetor që janë ndarë mjetet në Drejtorinë e Kadastrës për shpronësim. Pse mos ta bëjmë një gjë të tillë në lagjet ku komuna nuk ka pronë publike. Pse mos ta ndajmë një buxhet përmes Drejtorisë së Gjeodezisë dhe përmes atyre mjeteve të shpronësohet një pronë (qoftë edhe me një vendim të kuvendit) dhe të zgjidhet një çështje shumëvjeçare që i prekuron banorët e dy lagjeve në Rahovec, veçanërisht më keq është lagja “Vëllezërit Frashëri”. Në këtë lagje, nuk është bërë asgjë që shumë vite, përveç që disa shtëpi janë kyçur në kanalizim. Pastaj, projektet tjera: Ndërtimi i urave në Komunën e Rahovecit, ndërtimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore etj... janë të gjitha projekte në vazhdim. Pastaj, e kanë cilësuar si projekt të ri ndërtimin e rrugëve në qytet: “Ibrahim Rugova”, “Xhelal Hajda”, “Rifat Dina”. Në rrugën “Xhelal Hajda” janë investuar pothuajse 500.000€ në fund të mandatit të kaluar. Rruga “Ibrahim Rugova” është në rregull. Rruga “Rifat Dina” ndoshta mund të vlerësohet si një projekt i ri. Fushat sportive dhe parqet: Nagac, Rahovec, Pataqan i Poshtëm janë cilësuar si projekt i ri edhe pse ndoshta ka kontratë aktive për ndërtimin e tyre. Këtu është edhe një problem tjetër, kryetari Smajl Latifi në çdo propozim të buxhetit, nuk ka dhënë alternativë të zhvillimit të Komunës së Rahovecit. Këtu e pashë që është vlerësuar edhe ndërtimi i AMF-ve dhe renovimi i AMF-ve. Kjo mendësi duhet të ndërrohet dhe duhet të vijë një alternativë e re. Kryetari e përmendi që po bëjmë propozime për 2-3 vota, duke filluar nga 2-3 çdo votë është e nevojshme për të ardhur një mendësi e re, me një alternativë të re, e cila e bën një buxhet të ri që komuna të funksionojë ndryshe. Nuk mund të bëjmë fusha sportive që nuk i kryejnë punë askujt. Në Rahovec ka fushë të tenisit që është bërë në kohën e drejtoreshës Bjondinë Kleqka. Ajo fushë po shkatërrohet nga mosshfrytëzimi. Jam shumë i kënaqur që dy vitet e fundit subvencionet tejkalojnë shumën mbi 1 milion euro, por forma e subvencionimit duhet të ndryshojë në çdo sektor, sepse duhet ta bëjmë më atraktive çështjen dhe të zhvillohet më shpejt sporti e kultura. Më ka lënë përshtypje një projekt i ri “riparimi në nëntë shkolla fillore dhe të mesme” me

vlerë totale 25.000€. Nëse bën renovime kozmetike, ndoshta me 25.000€ mund të lyhen, por asnjë riparim tjetër nuk mund të bëhet dhe jo në 9 shkolla, duke e ditur gjendjen e objekteve të shkollave në Komunën e Rahovecit. Këtu është mësuar taktika për t'i marrur pikët, sipas kritereve të institutit GAP, të grantit të performancës dhe transparencës komunale, përderisa gjendja në terren lë shumë për t'u dëshiruar. E kam edhe një pyetje: në vitin 2021 kanë qenë 120.000€ të destinuara për rregullimin e varrezave të dëshmorëve dhe civilëve të vrarë në Rahovec. Tani nuk janë të përfshiera në buxhet, pse? Nëse ka qenë projekti në atë kohë, pse nuk është përfunduar në vitin 2021 dhe pse nuk po realizohet tani?

Burim Krasniqi: Kryetar, meqë jeni te foltorja. Nëse projekti i sheshit e kalon 4.2 milionshin, vlera e kalon 10% e kontratës bazë. A janë nënshkruar kontrata shtesë, qoftë të negocuara, apo vetëm i është shtuar vlera, nëse është kështu nuk është në rregull në qoftëse është shtuar direkt.

Kryetari: Janë kontrata të reja dhe nuk është shfrytëzuar ende 10%-shi. Unë llogaris që vitin e ardhshëm do të jetë edhe një projekt që lidhet me objektin "Hardhia" te aty ku është terraca e hotelit. Sa e dëgjova u përmend si projekt i ri rruga "Xhelal Hajda", ajo është një pjesë e hyrja e parkingut nëntokësor dhe nuk bëhet fjalë për rrugën te poshtë. Është unazë e re e qytetit që përfshin rrugën "Xhevat Kasapi dhe "Muharrem Dina", e cila e funksionalizon sheshin dhe ju jep mundësi të lehtë qytetarëve për qarkullim. I përmende varrezat e qytetit. Unë ju thash që ka shumë projekte që janë brenda kontratave valide. Në mesin e këtyre kontratave është edhe kontrata për varrezat e qytetit, e cila më parë nuk është kryer sepse ka pasur problem me identitet të martirëve. Në kontratën e re e kemi "rregullimin e varrezave të martirëve" në qytet. Çështja e tensionit të energjisë elektrike: Ju siguroj që i vetmi vend ku ka shpronësim dhe jemi në finale të shpronësimit është vendi për trafo në lagjen "Vëllezërit Frashëri". Besoj që KEDS-i shumë shpejt do ta vendos trafon në atë pjesë. Sa i përket kanalizimit në atë pjesë, ka filluar të zgjidhet dhe në një segment është zgjidhur. Jam marrë me këtë çështje shumë, i kam humbur këtu 4 orë dhe dikën se kam parë hiç, kam shkuar edhe atje 4 orë dhe në fund e kemi bërë marrëveshjen legale dhe ka vazhduar edhe një segment tjetër për 11 familje. Vazhdon përpjekja jo e lehtë, shumë sfiduese për ta zgjidhur problemin edhe në pjesë të tjera të qytetit. E kuptova thelbin kur e përmende "Grapecityn" duke thënë që në njërin anë bëhet ky ballkon panoramik dhe në anën tjetër nuk ka kanalizim. Është e vërtetë që ka këso zhvillime të "disbalancuara". Njëri tha që, pse e keni bërë ndriçimin publik atje, kurse ne nuk kemi ujë të pijshëm. Ujin e pijshëm duhet ta nisë KRU Gjakova dhe do ta përkrahim me 49% të mjeteve. Ne edhe në buxhet nuk guxojmë të fusim kode të huaja, sepse planifikohen nga KRU Gjakova dhe ne i mbështesim. Ndërsa me KEDS-in bëjmë marrëveshje për projekte të caktuara. Komuna e Rahovecit është vështirë ta ketë një buxhet zhvillimor, por, detyra jonë është që të krijojmë infrastrukturë që të ndodhë zhvillimi. Është pritur ndryshim i madh në Republikën e Kosovës nga disa politika që promovonin revolucion. Unë e di që revolucionin ka përfunduar në 1999 kur Kosova është çliruar nga Serbia dhe në 2008 kur Kosova është shpallur shtet. Ka edhe revolucione të tjera, siç është bashkimi kombëtar, por me këtë qeveri është problem të ndodhë kjo gjë. Mendësia: Para 3-4 viteve ndoshta ke qenë në karrigën ku sot është Arbëri dhe ke kërkuar ndonjë fushë sportive, apo fushë të tenisit dhe fakti që sot nuk po shfrytëzohen ato nuk do të thotë që investimet kanë qenë të gabuara. Të premtën do ta fillojmë një fushë sportive (me tartan) në Brestoc, që nuk është nga asambleisti Lirigzon Kastrati, por, unë me grant të performancës do ta bëj. Besoni që Komuna e Rahovecit është ndërtuar shumë dhe do të ndërtohet edhe më tutje. Buxheti për vitin 2025 është buxhet që është ndarë në përputhje me prioritetet e Komunës së Rahovecit, me prioritetet e kryetarit të komunës dhe ekipit të tij dhe me nevoja dhe kërkesa të qytetarëve. E tha edhe drejtori Afrim Limani që mbi 90% e kërkesave të qytetarëve janë paketuar në buxhetin për vitin 2025. Kur kam ardhur për herë të parë si kryetar i komunës, Rahoveci është quajtur qytezë dhe në terminologjinë time ka filluar të emërtohet si qytet. Pas sqarimeve që i ka Afrim Limani, ju lus që ta votoni buxhetin.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Kryetar, një sistem e kemi të mirë, nuk e di si e kanë komunat tjera, por mbi tre muaj keni pasur dëgjime buxhetore. Ajo që dua ta pyes drejtorin e Financave është që më intereson që në atë dëgjime buxhetore, në këtë rast po flas konkretisht për Krushë, cili është ai projekt që është futur në buxhet? Apo a është ndonjë projekt në listë të pritjes? E dyta, qëndrimi i PDK-së është mos të votohet buxheti, sepse nuk jemi të kënaqur me këtë ndarje buxhetore. Në mënyrë hipotetike nëse unë dua ta "tradhëtoj" PDK-në dhe e votoj buxhetin, çka t'i them unë krushianëve? Çka po fillon diçka e re aty? Te Drejtoria e Shërbimeve Publike, po e shoh që asnjë

rrugë nuk është për në Krushë të Madhe, pse? Ndërkaq, në të gjitha fshatrat pothuajse ka planifikime. Nëse ndonjëherë do ta votoja buxhetin është shkakut yt drejtor i kulturës, jo pse ti je më i miri, por, të gjitha atë që janë kërkuar janë kryer dhe nuk kanë çka të futen përsëri në buxhet të vitit 2025, nuk po e kuptoj. Kemi folur për një rrugë që të qon në Dri të Bardhë. Qytatarët e kanë kërkuar urbanizimin e zonës ndërtimore dhe një rrugë afër varrezave që të qon në qerdhe.

Kryetari: Faleminderit Sefë! Në Krushë të Madhe kanë ndodhur shumë projekte dhe ka projekte që janë duke ndodhur. Pushën e sportit me tartan ndoshta nuk e kemi kryer tërë pagesën, gjithashtu edhe për muze. Aneksi i ansamblit Bajram Curri është në prag të përfundimit dhe shpejt do të përrurohet. Janë disa punime që lidhen andej kah drini me hapësira për biznese që është një projekt gjigand për krejt kolektorin e ujërave të zeza, që i lidh Krushën, Xërxën dhe pjesën e Ratkocit, vlera 1.9 milionë. Për muzeun e masakrës ka rifilluar shpronësimi. E kemi shtratin e lumit i cili është vonuar, është fat që e ka marrë “Mendi” dhe do ta përfundojë. Është e vërtetë që në Krushë të Madhe shumë rrugë janë shtruar, por ka shumë që kanë mbetur pa u shtruar, kryesisht janë rrugë private me një gjatësi të caktuar. Për atë rrugën që lidhet me kompleks, të kam thënë dhe ju them krushianëve që ajo rrugë do të bëhet, shpresojmë që nuk do të kemi probleme pronësore. Pra, buxheti është vepra kryesore që duhet të betonohet nga kuvendi komunal, sepse me këtë buxhet do të operojmë nesër. Kontrata e mëhershme për rrugë fushore është ndërprerë dhe tani e ka “Mendi”. Kjo kompani është operacion intenziv sa i përket rrugëve fushore dhe operon mirë. Dikush mund të thotë, pse po e lëvdoni këtë operator! E lëvdoj, sepse është i mirë, bile ata janë me subjektin që ti i takon. Mendoj që Krusha e Madhe përfshihet në masë të madhe nga investimet publike, të vogla, të mesme dhe të mëdha. Nuk ka zonë që banohet, në qytet e fshat, që nuk është prekur dora e pushtetit lokal, ose e pushtetit qendror përmes pushtetit lokal, sa i përket investimeve. Në Mrasor janë 50 votues total, ndriçimi publik është 100%. Sa i përket KEDS-it, ne bëjmë punë të madhe duhet e rritur presionin te ta, për investime dhe për të gjitha punët tjera, si dhe për trafo, i kemi sfiduar dhe do ta përfundojnë shumë shpejt, sepse deri tani nuk kemi pasur pronë. Rasimin kam qejf ta dëgjoj se çka thotë, sepse është njeri me përvojë.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Fillimisht, e falënderoj drejtorin e Financave që na ka sjellë projekt-buxhetin për vitin 2025. Shumë shkurt, dëshiroj të ndërlihem me bisedat që u zhvilluan. Dua të them që, nga paslufta në Rahovec dhe në krejt Kosovën ka ndodhur mrekullia. Ndryshimi është i madh dhe nuk ka ndodhur me shekuj të tëra në të kaluarën. Kjo gjendje nuk ka mohon të drejtën që ne të kërkojmë ende gjëra që janë me prioritet. Dua të ndërlihem me projektet që janë këtu, që i kemi analizuar. Vërejtja ime shkon për drejtorat. Disa kode janë të përgjithësuara. Drejtor i Financave ka thënë që nuk e lejon sistemi, duke na treguar të dhënat e nevojshme. Kërkoj nga drejtorët që të na tregojnë konkretisht, p.sh: “Meremetimi i rrugëve dhe trotuarëve” duhet të dimë konkretisht se për cilat rrugë bëhet fjalë dhe për cilin fshat, sepse tani të gjitha rrugët i kemi me emërtime. Në fakt, kjo më shqetësor dhe është mirë që çdo projekt të jetë i specifikuar. Përgjithësimi nuk është i mirë dhe do ta ndryshoja këtë gjë, gjithashtu edhe ju është mirë të dilni dhe të flisni për këtë çështje. Specifikimi na bën të qartë edhe para qytetarëve dhe jemi në dijeni se këtë vit kush e ka rendin të punohet, vitin tjetër kush etj, etj... Kryetar, thatë më herët që pyetje të jenë konkrete, si dhe përgjigja të jetë konkrete. Në këtë kuvend, unë e kam ngritur shumë herë çështjen e rrugës, Fortesë – Celinë, por jo vetëm unë. Në këtë projekt-buxhet a e keni paraparë që kjo rrugë të meremetohet? Mandej, para 2-3 viteve (mos më kapni për kohe), e keni ndarë një rrugë që lidhet me rrafshin e malit. Drejtori i Shërbimeve Publike ose i Bujqësisë e ka hapur rrugën dhe e falënderoj shumë. Atë rrugë e quajmë “Ruga Vojsa” që del në rrugën te varrezat e Fortesës edhe te “Mella”. Aty afër është një rrugë “trup” që e lidhë Celinën me fusha dhe me rrugë kryesore. A keni ndonjë plan edhe për këtu? Këto dy përgjigje kam qejf t’i dëgjoj, meqenëse kryetari i nderuar, unë nuk kam ndonjë verzion tjetër të buxheti dhe jam ithtar i asaj që pavarësisht kush është kryetar, kuvendarët duhet ta votojnë buxhetin, ose duhet të kesh ndonjë mendim tjetër. Meqenëse unë nuk kam mendim tjetër, përpos që po i kërkoj këto sqarime, unë do ta votoj buxhetin.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë edhe një herë! Kur kemi folur për rënien drastike të numrit të banorëve në Komunën e Rahovecit, gjithmonë si indikator kryesor e kemi kemi menduar zhvillimin ekonomik të Rahovecit. Strategjia e dobët në planifikim të buxhetit dhe orientimi i tij në vendin jo të duhur me, apo pa qëllim. Sipas këtij buxheti të bazuar në qarkore buxhetore, e shohim se shumtë e ndara në sektorin e zhvillimit ekonomik janë pothuajse

absurde. Në 2024, shuma e ndarë në këtë sektor është 208.364€, në vitin 2025, 270.000€, të pasur me një rënie në vitin 2026 në 228.500€ dhe në vitin 2027, 242.685€. Nëse e bëjmë një krahasim të vogël me bujqësinë, e shohim një diskrepancë të madhe të planifikimit mes tyre. Buxheti për bujqësi sillet 1.5 milionë€ dhe zhvillimit ekonomik 200 mijë. Ne e dimë që jemi terren bujqësor, por të ndalemi të analizojmë se a është interesi i rinisë komplet në bujqësi? E shohim që nuk është dhe për këtë arsye ky është indikator kryesor që rinia e Rahovecit po ik prej këti vendi. Boll kemi freza, traktora dhe bodrume të verës, tani është koha që ta orientojmë rinin kah zhvillimi ekonomik. Shpesh herë e kam përmendur dhe subvencionimin e start-up bizneseve. Djemtë e vajzat e reja të Rahovecit po hapin kompani në Prishtinë dhe ne pse të mos ju ofrojmë kushte që ata këto kompani t'i hapin në komunën tonë. Kur ai/ajo e hapë një kompani në Rahovec, i punëson disa punëtorë këtu dhe të mirat vijnë zingjirë. Këto kompani është mirë që të kenë lehtësime edhe në taksa. Sipas meje është mirë të përdorim strategji të reja dhe t'i lëmë anash taktikat e vjetra për shpërndarje buxhetore sa për t'i marrur "tikat" e GAP-it dhe të grantit të performancës. Te subvencionimi ceket që është shuma mbi 1 milion, por, askund nuk e kam parë se si po ndahen. Kodi 49841 "Ndërtimi dhe vendosja e ashensorit në objektin e komunës" është 54.500€ dhe më është dukur shumë absurde, për kundër edhe punimeve tjera që kanë ndodhur aty. Është shumë goxha e lartë dhe kërkova prej njërit prej drejtorëve që shoh projektin dhe lëndën.

Vlora Vuçitërna Çmega: Përsëritet edhe një herë! Këtu te lista e projekteve që i kemi përpara, po e shoh vetëm "projekti i ri", "vazhdimi i projektit", fushë sportive, rrugë, lumenj, përrocka atj... Askund nuk e pashë një projekt për fëmijët tanë! A nuk janë ata pjesë e buxhetit? Është viti i tretë që jam pjesë e kuvendit dhe hera e dytë që e përmendi. Anjëherë gjatë këtyre viteve nuk e pashë një projekt për që i përfshin fëmijët. Besoj që një vend afër qytetit mund ta gjeni dhe të investoni sado pak për ndonjë kënd të lojërave. Pse të shkojmë të shpenzojmë në vendet e afërta, kur paratë mund t'i lëmë në Rahovecin tonë. Të vetmin send që e keni bërë është ajo që e keni ndihmuar shoqatën "Hareja", por, jo diçka konkrete.

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! Përsëritet për të gjithë! Tek projektet, ballkoni panoramik është mirë të bëhet "Grapeland", meqenëse shumica e banorëve të komunës janë mishëruar me këtë emër. Nëse ju keni vendosur që mos ta bëni kështu, për shkak të ndonjë inati, që sipas meje nuk ka vend në politikë, unë propozoj një ide tjetër. Unë them që mund kur vendet e ndryshme të Kosovës takojnë dikë nga Rahoveci. Nga 3 emrat e propozuar, "O RRUSH..." duket më tërheqës dhe autentik për Rahovecin. Kjo përdorë një fjalë që është pjesë e kulturës dhe identitetit lokal, ndërsa gjithashtu i jep një ndjesi tërheqëse turistëve. Ky emër do të ishte më origjinal për promovimin e zonës. Duhet pak guxim për ta vendosur këtë emër, por gjithsesi unë po e lë në tavolinë si propozim. Kur bëhet rregullimi i shtratit të lumit Sapniq, propozoj që të ndahet një pjesë e buxhetit edhe për krijimin e një akumulimi të ujit përgjatë lumit në formë rrethore, me gurë dhe të duket më natyral. Përgjatë rrjedhjes së lumit, mbushet kjo hapësirë dhe pas mbushjes lumi vazhdon rrjedhën e vetë, kjo ka pak kosto. Te ndërtimi i rrugëve në qytet, propozoj të shqyrtohet edhe rregullimi i rrugës që e lidhë pjesën e "Blatos" me Hamoc e Shtavicë. Kjo krijon hapësirë dhe qasje alternative për banorët, por edhe i lehtëson qindra fermerë që kanë prona aty. Te hapësirat e gjelbra, propozoj: Përskaj rrjedhave të ujit, kryesisht nga Zhdrella në Rimmik të gjendet hapësirë adekuate për mbjelljen e drunjëve "Selvi" që janë të gjatë, të cilat pas disa viteve me rritjen e tyre krijojmë një pamje shumë të bukur. Te ndërtimi i trtuarëve, që ka ardhur si kërkesë e këshillave të fshatrave: Te rruga "Gëzim Hamza" tani po bëhet sheshi dhe nxënësit po kalojnë e trotuare nuk ka, ju lutem bëni një zgjidhje. Në Sejanë propozoj të rregullohet rruga mirë me zhavor dhe të krijohet një hapësirë anësore për vrapim ose ecje, meqenëse rruga është e drejtë rreth 4km me një pamje anash shumë të bukur fushore. Tjetra, të investohet në bilborde, pra, të bëhet modernizimi i komunës, ku komuna mund të përfitojë nga qeratat. E fundit, propozoj që Burim Krasniqi të ulet me Smajl Latifin dhe të nisin seriozisht bisedat për mundësinë e krijimit të trafikut urban në Rahovec.

Defrim Kafexhiu: Pajtohem me propozimin e Ilirit, se edhe Iliri është si rrush. Faleminderit për mundësinë e fjalës kryesues, por, po ndihem keq në atë mënyrë që në momentin që ma jep fjalë, sikur po ma bën një hatër. Replika më takon.

Kryesuesi: Të lutem vazhdo, sepse je i vetmi që keni folur 2 orë e ca.

Defrim Kafexhiu: I nderuar kryesues! Më vjen keq, por kuvendi e ka rregulloren, pikat e rendit të ditës dhe unë kam të drejtë të diskutoj në çdo pikë të rendit të ditës, me minutazhë të caktuar dhe me të drejtë të replikës. Nëse të duket që kam folur shumë, po e marr si lëndatë. Faleminderit shumë! Te çështja e diskutimit politikë që e bëra unë për

projekt-buxhetin e vitit 2025, e respektoj secilin anëtarë të kuvendit dhe formën të cilin e japin ata me anë të propozimit të projekt-buxhetit prej ekzekutivit. Si Lëvizje Vetëvendosje e shohim më ndryshe çështjen e implementimit të buxhetit. Duhet ndryshime radikale, për të cilat duhet guxim dhe në të njëjtën kohë është edhe sprovë. A është punuar në Komunë të Rahovecit? Po, është punuar shumë në Komunë të Rahovecit edhe në infrastrukturë dhe në çështje të tjera. Kryetari e përmendi edhe kohën kur kam qenë i ulur atje. Është e vërtetë që ne bashkë me kohën kemi avancuar edhe politikisht, por edhe në njohjen e procedurave institucionale të implementimit të buxhetit, sukur çdo person tjetër. Unë besoj që edhe ju me kohë ia keni marrë dorën ktyre gjërave dhe besoj që duhet të evuloni edhe te kjo pjesë. Të paktën dikush siç e ka mbështetjen elektorale sikur ti, e ka më të lehtë këtë ndryshim, sesa një politikan tjetër klasim dhe që bën kalkulime në vota.

Afrim Limani: Edhe pse kryetari e shpjegoi në mënyrë të detajuar, unë e pashë të arsyeshme të dal për detaje të tjera në bazë të pyetjeve. Para jush e keni dokumentin e investimeve kapitale 2025-2027. Në kuadër të kësaj liste janë të futura të gjitha projektet që janë në vazhdim dhe projektet që kanë dalur si rezultat i kërkesave të qytetarëve. Çdo projekt në këtë listë është i mbuluar financiarisht. Për hir të transparencës, qëllimisht e kam lënë që t'i shihni edhe kontratat e vitit 2023 të cilat vazhdojnë. Nëse e shihni një kolonë të zbrazët në kuadër të vitit 2025, atëherë dihet që ajo kontratë është mbyllur dhe është buxhetuar. Burimi i ngriti disa pyetje: Te projekti “rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve” the që ky projekt nuk është i buxhetuar. Ky projekt është i buxhetuar dhe është në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit me vlerë 90.000€. I përmende edhe disa projekt të tjera, gypat, serrat, mekanizmat bujqësor dhe këto nuk figurojnë në listën e investimeve kapitale, por janë në kuadër të subvencioneve. Hartimi dhe mbikëqyrja e projekteve paguhen nga mallrat dhe shërbimet dhe nuk guxojmë t'i fusim në listën e projekteve kapitale. Te sheshi qëndror, këtë pyetje e ke bërë edhe në mbledhjen e KPF-së. Vlera e kontratës është 3.817.000€ dhe deri më tani janë paguar 1.541.000€ dhe kanë mbetur pa u paguar edhe 2,275.000€. Pyetja jote ishte se pse është buxhetuar më tepër. Dije një fakt që nëse buxhetimin e lëmë “mangu” atëherë ka rrezik. Ne e kemi buxhetuar, sepse mund të ndodh që ndërkohë dalin edhe punë tjera, sikur që ka ndodhur vendosja e trafos që ka kushtuar 73.000€. Projekti “Rruga për biznese dhe turizëm” për herë të parë po futet në investime kapitale, ndërsa ky projekt në vitin e kaluar është buxhetuar nga granti i performancës. Te shpronësimi, ne nuk kemi të drejtë të blejmë tokë. Tokën mund ta blejmë nëse e ndërtojmë një rrugë dhe nëse ka nevojë, sepse vlera e shpronësimit duhet të jetë në kuadër të projektit. Riparimi në nëntë shkolla fillore me 25.000€, pse kaq pak? Ky projekt është futur në sistem me bartjen e mjeteve, është buxhetuar dhe për vlerën e kontratës nuk kemi pasur mjete tjera dhe ka ngelur edhe për vitin e ardhshëm dhe me kaq do të mbyllet plotësisht kontrata. Merisë, më pëlqeu diskutimi yt që duhet ta rrisim buxhetin në zhvillim ekonomik, por, ky buxhet është planifikuar në bazë të kërkesave dhe prioriteteve. Kërkoj edhe një herë që ta votojmë buxhetin, sepse tek e fundit është i qytetarëve.

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! Po ndërlihem me pyetjen e Merisa Sharkut, është e vërtetë që në projeksione buxhetore Drejtoria për Bujqësi ka më shumë fonde, por kjo nuk nënkupton që nuk janë duke u realizuar projektet e investimeve kapitale. Së fundmi e kemi përruruar një projekt 150.000€ që është i dedikuar për biznese, janë tetë lokale afariste zejtare. Jemi duke vazhduar me investime edhe në zonën ekonomike, që është një projekt me vlerë 2.6milione. Sa i përket lirimin nga taksat afariste, Komuna e Rahovecit normat e taksave i ka shumë të ulta dhe për vitin 2023 për të gjitha bizneset që operojnë në Rahovec, rreth 2000 sosh është 106.000€ dhe i bie që për secilin biznes taks vjetore 53€. Sa i përket bizneseve start-up, i kemi subvencionuar vitin e kaluar, ka qenë kërkesë e juaja, por edhe planifikim i drejtorisë dhe i kryearit të komunës.

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Në pyetjen e bacës Rasim, në lidhje me rrugën Fortesë – Celinë: Ajo rrugë kërkon ritrajtim të ri, për shkak të situatës me probleme pronësore. Bashkë me kryetarin e kemi diskutuar që në kuadër të ndërtimit të rrugëve lokale, vitin e ardhshëm do ta hapim procedurën për atë rrugë. Kërkoj edhe prej juve dhe prej fshatit Fortesë dhe të gjithë banorëve andej, të marrim pëlqim që t'i trajtojmë edhe ujërat atmosferikë.

Berat Duraku: Faleminderit kryesues! Nuk më pëlqeu ajo që tha Merisa, që bujqësisë t'ia ulim buxhetin. Një pyetje direkte e pata nga Rasim Fazliu, në lidhje me një rrugë fushore që lidhet nga Celina deri te rruga e Hamocit. Një material që e kam shpërndarë, se di a ka arritur te ti, por kjo kërkesë është e aprovuar. Ju informoj që në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësis janë në procedurë edhe 11 kilometra rrugë, kryesisht vreshtare.

Kryetari: Është në procedurë riparimi i brendshëm dhe i jashtëm i objektit “Hareja” dhe objektit të “Hendikosit” me vlerë 660.000€. Ky investim do të krijojë hapësira më të përshtatshme për operimin e organizatave aty. Mendoj që ka shumë hapësira për zhvillimin e aktiviteteve rinore në komunën tonë, kulmi do të jetë Qendra për Rini, Kulturë, Arte dhe Inovacion. Ju falënderoj shumë për kontributin dhe konstruktivitetin. Pas një debati të gjallë dhe dinakim, e ftoj kryesuesin ta vendosë në votim projekt-buxhetin.

Rasim Fazliu: I falënderoj drejtorët, Beratin dhe Përparimin. E kam një moskënaqësi te drejtori i Shërbimeve Publike, sepse nuk ishte shumë i qartë dhe nuk më pëlqeu ajo siç e tha ai. Komuna është vetë institucion dhe i ka mekanizmat përcjellës, në qoftëse ne presim që dikush të lëshoj pe për ujëra apo për çka ishte fjala, ajo rrugë nuk do të bëhet edhe 200 vjet. E ftoj drejtorin, bashkë me të gjithë të tjerët që ajo rrugë të rregullohet, i keni mekanizmat. Ne mund ta japim kontributin tonë si qytetarë të vulltetit të mirë.

Ilir Pallqa: Unë i kam bërë tri propozime dhe ndoshta i merrni parasysh pas përfundimit të seancës. Qendra multifunkionale po vazhdon me intensitet të lartë. E falënderoj rastin që ta falënderoj Bjondinën, e cila e ka nisur këtë projekt dhe gjithashtu Visar Korenicën, pa të cilin nuk do të bëhej kjo. Unë e di, ndoshta ju nuk e dini, Visar Korenica ka qenë insistuesi më i madh për t’u ndërtuar kjo qendër, të cilën e keni filluar ju.

Kryetari: Publikisht e kam falënderuar ministrin. Përndryshe është nisur me Smajl Latifin kryetar, Bjondina Kleqka, drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe pastaj Visari është bashkuar në këtë iniciativë.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë, e vendosim në votim pikën e katërt, e cila ka të bëjë me miratimin e buxhetit për vitin 2025. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 16 vota “për”, 8 kundër dhe 4 abstenim, miratohet buxheti për vitin 2025 për Komunën e Rahovecit. Urime!

5. Informatë nga DKA-ja rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025;

Avni Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, anëtarë të kuvendit. Do t’i numëroj disa nga aktivitetet që i kemi bërë gjatë muajit gusht, para fillimit të vitit të ri shkollor. Janë zhvilluar punimet në riparimin dhe rregullimin e nyjeve sanitare në objektin e shkollës fillore “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe. Më në fund, çerdhja në Xërxë është pajisur me inventarin e kuzhinës. Kanë përfunduar riparimet e brendshme në shkollën fillore, “Skender Kastrati” – Gexhë. Kemi pasur një vizitë verifikuese nga komisioni i MASHT-it për tri çerdhet e reja të ndërtuara, të cilat edhe zyrtarisht do të themelohen si institucione të reja të edukimit parafillor. Kanë përfunduar riparimet e brendshme në objektin e shkollës “Gëzim Hamza – Piktori” në Rahovec. Në shkollat e reja në Xërxë, Ratkoc dhe Pastasel gjatë muajit gusht kanë vazhduar punimet. Punimet vazhdojnë të zhvillohen edhe në ndërtimin e çerdes së re në lagjen e epërme në qytet. Gjatë muajit gusht po ashtu ka përfunduar edhe ndërtimi i rrethojës së oborrit në çerdhen “Tulipanët”. Ka përfunduar trajnimi i tre grupeve të mësimdhënësve dhe edukatorëve, i cili zgjati 6 ditë me radhë. Është zhvilluar një takim me drejtorët e shkollave dhe me koordinatorë të cilësisë, gjithashtu i mbajtëm edhe dy takime, një në shkollën “Katër Dëshmorët” dhe një në shkollën “Ukshin Hoti”. Më datë, 31 gusht është mbajtur provimi i maturës për maturanët, i vlefshëm për afatin e gushtit që në qershor nuk e kanë arritur pragun e kalueshmërisë. Në fillim të vitit të ri shkollor jemi përballur me dy sfida: Planifikimi i kuadrit, sidomos për shkollat e mesme të larta, sepse ka ndodhur një zvogëlim shumë i madh i numrit të nxënësve dhe furnizimi me tekste, sepse janë vonuar me sjelljen e teksteve që kanë qënë të përpiluara nga katalogjet e DKA-së në Ministrinë e Arsimit.

Burim Krasniqi: Faleminderit për prezanzimin! Një pyetje konkrete, si qëndron puna e furnizimit me lëndë djegëse nëpër shkolla? Disa herë ka qenë sfidë, sidomos te periudha e rritjes së çmimeve. Ju kërkoi të na përcjellni një informatë, ose një analizë se pse po ndodh zvogëlimi i numrit të nxënësve të klasëve të dhjeta. Të na përcjellni një informatë se në cilat shkolla ka mungesë të kuadrit specifik në matematikë, fizik dhe nëse nuk gabojuar së fundi është edhe gjeografia.

Sejfullah Sejfullahu: Në mbledhjen e fundit të këshillit drejtues të shkollës “Bajram Curri” e kemi informuar drejtorin që është një dukuri jo e hijshme, e kam fjalën që për subvencione ishin të regjistruar mbi 600 nxënës, kurse me shkollim aktiv në Krushë të Madhe janë 480. Pse është kjo dukuri?

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! I kam disa pyetje për drejtorin e DKA-së. Dëshiroj të jem në dijeni rreth cilësisë së arsimit në komunën tonë. Cili është niveli i progresit që keni arritur? Sa është numri i mungesave të nxënësve dhe mësimdhënësve për komplet vitin shkollor dhe sa po arsyetohen mungesat? Cilat shkolla po sfidohen

në komunën tonë me rënie të numrit të nxënësve? Në shkollat e mesme të ulta, a janë të funksionalizuara të gjitha trupat profesionale brenda institucionit edukativo-arsimor?

Defrim Kafexhiu: E kam një pyetje dhe një kërkesë për drejtorin e DKA-së. Kryetari më herët i përmendi bursat, këtë vit vlera e tyre arrin 97.000€. Kjo vlerë është e konsiderueshme dhe është më e madhja ndonjëherë që është ndarë në DKA për çështje të bursave. Do të dëshiroja që, qoftë në këtë raport që është, qoftë në raportin e vitit të ardhshëm të drejtorisë, të ndryshohet dhe të shtohet edhe suksesi i nxënësve dhe studentave që po mbështeten me bursa. Është jo e logjikshme që nëse jepen bursat dhe nuk kanë efekt në rezultat pozitiv. Besoj që anëtarët e kuvendit duhet të jenë të njoftuar për suksesin e atyre nxënësve, të paktën në përgjithësi të përfshihet niveli i suksesit të përfuturësve.

Ilir Pallqa: Në shkollën “Gëzim Hamza” vjen një erë e padurueshme që 20 vjet. Drejtori është pjesë e ekzekutivit në drejtori të Arsimit që 8 vjet dhe nuk e ka marrë asnjë masë. Në atë shkollë ka nxënës të komunitetit joshumicë dhe i bie të jetë diskriminin. Si ajo delirantja Arbërie Nagavci, si i nderuari Avni Morina po bëjnë diskriminim të vazhdueshëm. Unë mendoj që po të ishte ndonjë shkollë tjetër, ky problem do të ishte rregulluar deri tash. Qëndroj fuqishëm në atë që e kam thënë në seancën e kaluar. Personat që bëjnë diskriminin duhet të shkarkohen dhe kjo është njëra prej arsyeve, duke mos i përmendur aktakuzat e punësimit.

Vlora Vuçitërna Çmega: Meqenëse materiali m’u duk pak i mangët, unë i kam disa pyetje për drejtorin. A keni shtuar staf në çerdhen “Tulipanët”, duke e pasur parasysh numrin e madh të fëmijëve aty? A keni bërë dezinfektim të shkollave, sikurse që bëhen nëpër komuna tjera? Meqenëse e tha Iliri që ka shkolla që kundërmojnë, nëse është e mundur të shtohet numri i mirëmbajtësve. Në material e ke cekur që nxënësit kanë pasur problem me blerje të librave dhe ju si drejtori i keni dalë në ndihmë. Për çfarë ndihme është fjala?

Avni Morina: Faleminderit të gjithëve për pyetjet! E ftoj Ilirin, bashkë me mua të shkojmë në shkollën “Gëzim Hamza”, sepse e kemi përfunduar procesin e riparimit aty dhe gjithashtu e kemi zgjidhur edhe problemin e kundërmimit. Nuk mendoj që është diskriminim, sepse kemi shkolla që e kanë gjendjen fizike më të dobët sesa kjo shkollë. Po Vlorë, është e vërtetë që e kemi rritur numrin e stafit të edukateve në çerdhe, sepse tani janë 174 fëmijë, para 3 viteve kanë qenë vetëm 53. Numri është bërë 15 edukatore, bashkë me drejtoreshën. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë, e bëjmë rregullisht dezinfektimin e objekteve shkollore. Sa i përket asaj që the te ndihma që kemi arritur t’i ofrojmë prindërve. Përmes drejtorëve të shkollave i kemi këshilluar disa prindë për formën e aplikimit në eKosova. Ka pasur raste që kanë ardhur edhe në DKA. E falënderoj zyrtarin Ardian Rama, Ardit Halilaj, Jetonin dhe Lulin, të cilët iu ka dhënë udhëzime. Kemi probleme ende, sepse nxënësit nuk i kanë librat adekuate që duhet, kjo ndoshta është papërgjegjësi e drejtorëve të shkollave, por jo edhe aq, sepse vetëm dy ditë kanë pasur kohë për të aplikuar, ndërsa përpara kemi pasur një muaj kohë për t’i përcaktuar tekstet shkollore. Te Defrim Kafexhiu, numri i studentëve që kanë fituar bursa, këtë vit ka qenë 190 në total, ndërsa i kemi subvencionuar edhe 40 nxënës, të cilët janë të shkëlqyeshëm dhe i kanë kushtet e dobëta ekonomike. Janë edhe 4 bursa që i ka dhënë fondi “Shoqërie Makshana”, një bursë e ka dhënë asambleisti Drilon Mustafa dhe një tjetër Eqrem Spahiu. Te asambleisti Burim Krasniqi, zvogëlimi i numrit të nxënësve është fenomen që po ndodh në krejt Kosovën. Te furnizimi i lëndëve djegëse, kontrata është e lidhur dhe gjatë kësaj jave do të fillojë furnitimi, sepse drejtorët e shkollave deri të premtën duhet t’i dorëzojnë kërkesat e tyre për furnizim. Te kuadri specifik, është e vërtetë që për matematikë e kemi problem, sepse nuk ka kuadro të matematikës. Në vend të tyre kemi pranuar inxhinierë të ndërtimtarisë, arkitekturës dhe të shkencave kompjuterike, sepse nuk mund t’i lëmë nxënësit pa mësim.

Burim Krasniqi: Nuk kërkoja përgjigje menjëherë, por kërkoja analizë!

Avni Morina: Tani për tani nuk i kam statistikën, por mund të merret testi i arritshmërisë dhen të ndahet numri se sa kanë dalur prej klasës së nëntë dhe sa e kanë vazhduar klasën e dhjetë në katërt shkollat e mesme të larta që i kemi në komunën tonë.

6. Shqyrtimi i informatës nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport rreth muajit të mërgimtarëve;

Afrim Dina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar asambleistë. Besoj që materialin e keni para vetes dhe ju ka arritur me kohë. Janë mbajtur shumë aktivitete për 30 ditë, nga 15 korriku – 15 gusht. Aktivitetet kanë filluar nga zyra e kryetarit të komunës, i cili i ka pritur mërgimtarët, në administratë ka pasur sportel enkas për mërgimtarët tanë. Gjatë kësaj kohe, mërgimtarëve u janë dhënë 5640 dokumente të ndryshme.

Drejtoria për Ekonimi dhe Drejtoria për Shëndetësi i kanë mbajtur aktivitetet e tyre për mërgimtarë. Te Drejtoria për Shëndetësi për herë të parë është ndarë çmimi “Ali Sokoli”, të cilin e ka fituar doktori i njohur Sadri Bajraktari. Është mbajtur “Agrofest”, më 3-4 gusht. Kemi organizuar turnin në futboll në Krushë të Madhe. Në fund, dua t’i falënderoj të gjithë kryetarët e këshillave të fshatrave, aty ku i kemi mbajtur aktivitetet. I falënderoj bizneset që operojnë në rrugën “Xhevat Kasapi” dhe policinë e Kosovës për kujdesin e shtuar gjatë këtij muaji.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – lokalet afariste te stacioni i autobusëve në Rahovec;

Erhan Morina: Para jush e kemi materialin për dhënien në shfrytëzim të 8 lokaleve afariste zeytare. Lokalet janë pronë e komunës, kanë një sipërfaqe që varion prej 50-85m² dhe jepen në shfrytëzim për 10 vjet për qëllime biznesore. Të hyrat e inkasimit të qerasë do t’i jepen në shfrytëzim stacionit të autobusëve, me qëllim të stabilizimit të gjendjes financiare që për momentin e kanë të përkeqësuar.

Kryesuesi: Nëse nuk kemi pyetje, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Konstatoj që unanimisht (19) votohet pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe shqyrtimi e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për lokalet afariste te stacioni i autobusëve në Rahovec;

Erhan Morina: Kjo pikë ndërlidhet me vendimin paraprak. Komisioni i ka 5 anëtarë, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.

Kryesuesi: Atëherë, vazhdojmë me propozimet!

Hasan Përboqi: AAK, Romir Zhuniqi!

Merisa Sharku: LVV, Vlora Vuçitërna!


Burim Krasniqi: LDK, Lirigzon Kastrati!

Sejfullah Sejfullahu: PDK, nuk ka propozim!

Illir Pallqa: I pavarur, nuk ka propozim!

Kryesuesi: Atëherë, kush është “për” Romir Zhuniqin?... Kush është “për” Vlora Vuçitërna?... Kush është “për” Lirigzon Kastratin?... Atëherë, me 16 vota Romir Zhuniqi, 10 vota Lirigzon Kastrati janë dy anëtarë të komisionit. Dy të tjerë janë nga ekzekutivi, Besmire Bytyqi dhe Erhan morina dhe një nga shoqëria civile. Si të tillë e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime (17) pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, formohet komisioni. Faleminderit për vëmendjen, shihemi në seancat e radhës.

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

